



## QPR, “struktura port ku hyn gjaku i ri” në FA

Reformimi i Forcave të Armatosura në kuadër të anëtarësimit në NATO dhe standardizimi i tyre strukturor çoi në krijimin e një strukture të re personeli, Qendrën e Personel Rekrutimit, e cila do të kishte si mision rekrutimin e ushtarëve aktivë dhe administrimin e dosjeve të personelit ushtarak të Forcave të Armatosura. Në vijimësi, misioni dhe detyrat e Qendrës së Personel Rekrutimit kanë evoluuar në funksion të strukturës dhe ndryshimeve ligjore të ndodhura në FA.

Misioni i kësaj qendre është rekrutimi i kandidatëve për oficerë e ushtarë/detarë aktivë, promovimi dhe informimi i publikut, përpunimi dhe administrimi i dokumentacionit dhe i të dhënave të personelit të ushtarakëve aktivë dhe atij në rezervë/lirim, realizimi i trajtimit financiar të ushtarakëve në rezervë/lirim si dhe vënia në efikasitet e burimeve njerëzore dhe materiale në raste të gjendjes së jashtëzakonshme. Qendra e Personel Rekrutimit e filloi veprimtarinë e

saj, më 22 qershor të vitit 2007, si një domosdoshmëri e zhvillimit të Forcave të Armatosura, me një mision mjaft domethënës siç është ai i menaxhimit të ciklit jetësor të burimeve njerëzore të FA-së. Sot, mund të thuhet se QPR zhvillon një proces rekrutimi, i cili garanton që Forcat e Armatosura shqiptare të kenë në gjirin e tyre një brez të ri, që është në gjendje të kryejë më së miri të gjitha detyrat në përmbushje të misionit kushtetues...

» faqe 10



## Ministri Peleshi pret shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Rumanisë



» faqe 3

SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim zyrtar SHSHPFA të Malit të Zi, gjeneral brigade Zoran Lazarević

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të SFARSH, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një takim zyrtar me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Malit të Zi, gjeneral brigade Zoran Lazarevic. Takimi mes dy homologëve u fokusua në bashkëpunimin ushtarak dypalësh midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal, por edhe më tej, në kuadër të misioneve dhe aktiviteteve të përbashkëta edhe të NATO-s. Të dy bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e vazhdimit dhe rritjes së bashkëpunimit ushtarak midis...



» Faqe 2

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu merr pjesë në takimin e zv/shefave të Shtabit të Europës Juglindore në kuadrin e SEDM

Në kuadrin e iniciativës së SEDM-it (South-Eastern Europe Defense Ministerial) kryesuar nga Bullgaria, në Romë u zhvillua takimi i zëvendëshefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore anëtare të SEDM-it, ku Italia ishte në rolin e vendit pritës. Ky është një takim i përvitshëm, që ka për qëllim promovimin e bashkëpunimit konstruktiv ushtarak rajonal në Evropën Juglindore (EJL), me qëllim të rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit, stabilitetit, besimit dhe sigurisë në rajon e më gjerë. Vitin e kaluar ky takim u zhvillua në Lubjanë të Sllovenisë...



» Faqe 2

Gjeneral brigade Xhebexhia: Suksesi për çdo detyrë kërkon që të afrosh zemrën, mendjen dhe vullnetin në çdo kohë

Forca Tokësore u krijua më 29 gusht të vitit 2000, duke përfshirë në radhët e saj njësi dhe reparte me traditë me një veprimtari të pasur shumëvjeçare, të përhapura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sot Forca Tokësore është njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura. Me një përbërje prej 5 divizionesh këmbësorie me rreth 55 brigada dhe 300 batalione në 167 rajone të ndryshme të vendit, Forca Tokësore u përfshi në një proces transformimi të thellë e të gjithanshëm sipas koncepteve të ushtrive perëndimore dhe me kalimin...



» Faqe 6

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një takim zyrtar me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Malit të Zi, gjeneral brigade Zoran Lazarević.

Takimi mes dy homologëve u fokusua në bashkëpunimin ushtarak dypalësh midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal, por edhe më tej, në kuadër të misionëve dhe aktiviteteve të përbashkëta edhe të NATO-s.

Të dy bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e vazhimit dhe rritjes së bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve, sipas planeve të bashkëpunimit ushtarak bilateral si dhe atyre në kuadër të NATO-s dhe iniciativave rajonale.

## SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim zyrtar SHSHPFA të Malit të Zi, gjeneral brigade Zoran Lazarević



## SHSHPFA pret shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së rumune, gjeneral Daniel Petrescu

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim zyrtar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura rumune, gjeneral Daniel Petrescu. Në takimin e zhvilluar mes dy homologëve u diskutua mbi bashkëpunimin bilateral, në kuadër të nismave rajonale BCHOD dhe SEDM, po ashtu në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta si dy vende anëtare në NATO-s, si dhe mbi situatën aktuale të mjedisit të sigurisë dhe sfidat ekzistuese në rajon.

Përgjatë takimit, Gjeneral Kingji u shpreh se "Siguria në Ballkanin Perëndimor është një prioritet për të gjitha vendet e këtij rajoni dhe më gjerë. Krahas trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta shumëkombëshe, vlerësojmë se rritja e bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy ushtrive tona do të ketë vëmendjen tonë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira profesionale dhe rritjes e ndërveprueshmërisë si dy vende anëtare në NATO".

Gjeneral Petrescu nga ana e tij u shpreh se: "Shqipëria është një aleat dhe një vend partner i vërtetë që gjithmonë është i gatshëm të përkrahë çdo nismë në mbrojtje të sigurisë rajonale, gjë për të cilën përcjell vlerësimet më të mira në emër të shtetit Rumun".

Gjatë vizitës zyrtare 2-ditore, gjeneral Daniel Petrescu do të zhvillojë takime të rëndësishme zyrtare, me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj dhe ministrin e Mbrojtjes, Niko Peleshi.



### Xhenierët e Batalionit të Xhenios në ndihmë të komunitetit

Xhenierët e Batalionit të Xhenios mundësuan lidhjen me rrugë automobilistike të një lagjeje në fshatin Mamël, Bashkia Elbasan


Prej shumë vitesh banorët e lagjes Çarje të fshatit Mamël në bashkinë Elbasan, nuk kishin mundësi komunikimi me mjetet e tyre me pjesën tjetër të fshatit duke iu sjellë vështirësi në transportin e mallrave dhe njerëzve.

Kërkesës së banorëve për një rrugë iu përgjigjën specialistët xhenierë, të cilët nga data 12 deri 19 qershor 2023 punuan për hapjen e rrugës së re dhe lidhjen e lagjes me pjesën tjetër të fshatit.

11 specialistë xhenierë me 2 mjete dhe 1 agregat bënë të mundur hapjen e rrugës automobilistike, duke kryer prishje masivi shkëmbor me eksploziv rreth 595 m3, prishje mekanike me matrapik 8m3 dhe duke hapur një rrugë prej 107 m.

Kjo rrugë bën të mundur lidhjen e lagjes me fshatin si dhe krijon mundësi që mjetet e transportit të futen në lagje.





# Ministri Peleshi pret shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Rumanisë

**M**inistri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi priti në një takim shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Rumanisë, gjeneral Daniel Petrescu, i cili shoqërohej nga ambasadori i Rumanisë në vendin tonë, z. Octavian Ierban dhe atasheu ushtarak, kolonel Valerică Piroică.

Në këtë takim u vlerësua bashkëpunimi mes dy vendeve në fushën e Mbrojtjes. Diskutimi u përqendrua veçanërisht në zhvillimet dhe angazhimet e të dy vendeve në mjedisin aktual të sigurisë, përpjekjet e përbashkëta për mbështetjen e Aleancës ndaj Ukrainës.

Mes ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi dhe delegacionit të Rumanisë u diskutua mbi identifikimin e fushave të reja për bashkëpunim të përbashkët në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë, si dhe përpjekjet e pandalshme të vendeve për kufizimin e influencave keqdashëse në rajonet respektive.



## Forca Ajrore së shpejti do të këtë në përdorim mjete ajrore pa pilot

**N**ë komandën e Forcës Ajrore u realizua "Site Survey", si pjesë e kontratës që qeveria shqiptare ka me kompaninë turke për furnizimin me sistem mjete ajrore pa pilot "Bayraktar - TB2".

Qëllimi i vizitës ishte studimi dhe vlerësimi i terrenit/infrastrukturës për instalimin e sistemeve për përdorimin e dronëve (UAV TB2).

Ekipi përfaqësues i kompanisë turke u prit nga komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili shprehu mbështetjen maksimale për fillimin sa më parë të këtij projekti.

Takimet u zhvilluan në harkun kohor njëjavor, pjesë e takimeve ishin përfaqësues të Shtabit të Forcës Ajrore, Drejtorisë së Modernizimit, Drejtorisë së Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm dhe Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.

Pajisja me këto mjete ajrore pa pilot që do të administrohen dhe përdoren nga Forca Ajrore, mund të gjejnë përdorim edhe në fushat e tjera të veprimit.



# Gjeneralmajor Manushaqe Shehu merr pjesë në takimin e zëvendësshefave të Shtabit të Europës Juglindore në kuadrin e SEDM

Në kuadrin e iniciativës së SEDM-it (South-Eastern Europe Defense Ministerial) kryesuar nga Bullgaria, në Romë u zhvillua takimi i zëvendësshefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore anëtare të SEDM-it, ku Italia ishte në rolin e vendit pritës. Ky është një takim i përvitshëm, që ka për qëllim promovimin e bashkëpunimit konstruktiv ushtarak rajonal në Evropën Juglindore (EJL), me qëllim të rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit, stabilitetit, besimit dhe sigurisë në rajon e më gjerë. Vitin e kaluar ky takim u zhvillua në Lubjanë të Sllovenisë.

Në këtë takim morën pjesë zëvendësshefat e Mbrojtjes/Shtabit të Përgjithshëm nga shtetet anëtare të SEDM-it. Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, nënkolonel Luli Florini, komandant i kurseve pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Kapiten i Rangut të Dytë Bedo Mërruka, oficer shtabi në Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.

Takimi u hap nga Drejtoresha e Sekretariatit të SEDM-CC/PMSC znj. Daniela DIMITROVA, Drejtor i Politikave të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes së Bullgarisë. Në rolin e vendit pritës përshëndeti Sekretari i shtetit për Mbrojtjen z. Perego di Cremnago dhe zëvendësshefi i Shtabit të Mbrojtjes të Italisë, gjenerallejtënant Carmine MASIELLO.

Më tej komandanti i SEEBRIG-ut, gjeneral brigade Evangelos MITROUTSIKOS, mbajti një prezantim mbi aktivitetet dhe veprimtarinë e kësaj brigade, nga takimi vitit të kaluar mbajtur në Lubjana të Sllovenisë dhe deri tani.

Gjithashtu përshëndetën të gjithë zëvendësshefat e Shtabeve të vendeve pjesëmarrëse.

Në fjalën e saj, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, pasi shprehu konsideratën më të lartë për arritjet e SEDM-it nën drejtimin e Bullgarisë dhe ndaj zëvendësshefit të Mbrojtjes të Italisë, gjenerallejtënant Carmine MASIELLO për mikpritjen, si dhe të



gjithë homologët e saj, ndërmjet të tjerash u shpreh: "Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura dënojnë fuqishëm agresionin e Rusisë ndaj Ukrainës dhe mbështesim plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Në përgjigje të nevojave aktuale të Ukrainës dhe brenda kapaciteteve tona ne po vazhdojmë të mbështesim Forcat e Armatosura të Ukrainës dhe popullin ukrainas. Ky konflikt është një kërcënim potencial veçanërisht për rajonin tonë, për shkak të aktiviteteve ruse për të pasur ndikim në Ballkan. Në këtë drejtim, ne duhet të bëjmë gjithçka për t'i mbajtur larg këto kërcënime dhe është detyra jonë të pasqyrojmë unitet dhe stabilitet në kombet tona. Besoj se me fokus të qartë dhe vullnet të fortë, forcat tona të armatosura do të vazhdojnë të mbështesin njëra-tjetrën në sfidat e ardhshme. Jam e sigurt se rruga jonë për të rritur vazhdimisht stabilitetin dhe sigurinë në rajon, është rruga e unitetit dhe e bashkëpunimit ushtarak.

Dëshiroj gjithashtu të përgëzoj

komandantin e SEEBRIG-ut, gjeneral brigade Evangelos MITROUTSIKOS për arritjet e kësaj njësie gjatë këtij viti, me besimin se edhe me marrjen e postit të komandantit të SEEBRIG këtë vit nga Shqipëria, do të ecë në rrugën e mirëkuptimit e të bashkëpunimit me të gjitha vendet kontribuuese në këtë nismë rajonale në dobi të paqes e sigurisë", - përfundoi fjalën e vet gjenerale Shehu.

Në fund të takimit pjesëmarrësit dolën me një deklaratë të përbashkët, ku ndërmjet të tjerash, shprehën mirënjohjen për fjalën e hapjes tepër frymëzuese të Drejtoreshës së Sekretariatit të SEDM-it, znj. Daniela DIMITROVA dhe zëvendësshefi i Mbrojtjes së Romës, gjenerallejtënant Carmine MASIELLO. Duke qenë se ky ishte takimi i dytë i DCHOD që kur Sofja mori kryesimin nga Tirana, në korrik 2021, ata vlerësuan punën e kryetarit të SEDM-CC/PMSC dhe vlerësuan përparimin e bërë nën udhëheqjen e Sofjes.

Gjithashtu pjesëmarrësit dënuan agresionin ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës, si një shkelje flagrante të së drejtës ndërkombëtare. Ata u shprehën të shqetësuar që lufta vazhdon të ketë pasoja në Ballkan dhe në të gjithë kontinentin evropian. Ata bënë thirrje për një ndërprerje të menjëhershme të armiqësive dhe mbështetjen për përpjekjet e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale për t'i dhënë fund luftës dhe për të mbrojtur refugjatët.

Zëvendësshefat e Shtabit vlerësuan përditësimet mbi aktivitetet e SEDM-CC/PMSC që nga takimi i fundit i SEDM DCHODs, organizuar në Lubjanë në qershor 2022. Ata theksuan rëndësinë e vendimeve të marra nga Ministrat e Mbrojtjes të SEDM-it në takimin e tyre të fundit në Sofje në nëntor 2022 dhe nevojën për të mbajtur marrëdhënie të ngushta pune me organizatat përkatëse ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit riafirmuan progresin e bërë përmes procesit SEDM-it ndër vite, duke punuar së bashku dhe duke qëndruar të bashkuar, duke theksuar se uniteti është forca jonë. Kjo nismë ka forcuar marrëdhëniet e kombeve tona dhe ka mbështetur përpjekjet e tyre drejt një të ardhme të përbashkët euroatlantike, në përputhje me politikën dhe aspiratat e tyre individuale.

Ata rikonfirmuan angazhimin ndaj qëllimeve dhe parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të drejtës ndërkombëtare, traktateve dhe marrëveshjeve. Gjithashtu rikonfirmuan angazhimin e përbashkët për të kontribuar për paqen dhe besimin dhe për të nxitur marrëdhëniet e mira fqinjësore përmes bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha shtetet e Evropës Juglindore.

Theksuan përkushtimin për paqen dhe stabilitetin rajonal dhe njohën nevo-

jën për të vazhduar përpjekjet e bashkëpunimit rajonal të lidhura ngushtë me sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar. Pjesëmarrësit u fokusuan në SEEBRIG dhe zhvillimin e projekteve rajonale për bashkëpunim dhe mbrojtjen e paqes dhe demokracinë në rajon.

Pjesëmarrësit vunë në dukje raportin e komandantit të SEEBRIG, gjeneral brigade Evangelos MITROUTSIKOS, mbi aktivitetet e shtabit të SEEBRIG që nga mbledhja e fundit e DCHOD-ve. Ata shprehën vlerësimin për përpjekjet e tij për të rritur efektivitetin e SEEBRIG dhe për të kërkuar në mënyrë aktive mundësi për të kontribuar në paqen, sigurinë, stabilitetin dhe bashkëpunimin në Evropën Juglindore.

Ata shprehën mirënjohjen dhe vlerësimin për Athinën për planifikimin dhe kryerjen e stërvitjes "SEESIM-22", si një mjet i vlefshëm për promovimin e bashkëpunimit dhe ndërveprueshmërisë në kuadër rajonal, si dhe arritjet e Bukureshtit si mikpritëse e Projektit "Femra Lidere në Siguri dhe Mbrojtje në 2022". Për më tepër, ata vlerësuan përpjekjet e RACVIAC si një organizatë e rëndësishme ndërkombëtare në Evropën Juglindore për forcimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal si një mjet për rritjen e hapjes dhe transparencës midis vendeve tona, duke u angazhuar për të promovuar dhe mbështetur më tej përpjekjet e RACVIAC. Në fund të takimit, pjesëmarrësit falënderuan zëvendësshefin e Mbrojtjes së Italisë, gjenerallejtënant Carmine MASIELLO dhe stafin nga Roma për pritjen dhe për përpjekjet e tyre të palodhura për të siguruar suksesin e këtij takimi të rëndësishëm rajonal.

Takimi i radhës sipas kalendarit do të zhvillohet në Ankara, Turqi, në muajin qershor 2024.



# Përfundon me sukses Stërvitja e Iniciativës Rajonale "ADRION"

Në kuadër të Iniciativës Rajonale "ADRION", në Taranto të Italisë, u zhvillua Stërvitja Rajonale "ADRION LIVEX/CAX - 2023", me pjesëmarrjen e anijeve dhe efektivëve të Forcave Detare të Shqipërisë, Italisë, Greqisë, Kroacisë dhe Malit të Zi.

Qëllimi i stërvitjes ishte përmirësimi i ndërveprimit të Forcave Detare të vendeve pjesëmarrëse në Iniciativën Rajonale "ADRION", në kryerjen e operacioneve të ndryshme detare si operacionet e ndalimit detar, kërkim - shpëtim, manovrimi detar, komunikimi si dhe trajnimin e procedurave në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve shumëkombëshe për të forcuar sigurinë e përgjithshme në det.

Një pikë tjetër e rëndësishme e stërvitjes ishte trajnimi i ekuipazheve në përdorimin e procedurave standarde të funksionimit sipas manualeve të NATO-s.

Gjatë zhvillimit të stërvitjes u zhvilluan skenarët stërvitorë "Kërkim - Shpëtim", "Operacionet e Ndalimit Detar", "Operacione të ndryshme detare" si dhe stërvitja përfundoi me qitje reale detare me artileritë e anijeve.

Gjatë stërvitjes një ekip i Brigadës "San Marco" u ul nga helikopteri në anijen "Oriku për bordimin e saj, ndërkohë që anija vijonte lundrimin duke simuluar një situatë reale.

Stërvitja theksoi edhe njëherë

rëndësinë mbi bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërmjet forcave detare të vendeve të rajonit që lagen nga deti Adriatik dhe Jon. Gjithashtu u nënvizua rëndësia e vijimit të iniciativës ADRI-ON, për rritjen e sigurimit detar të rajonit, për forcimin dhe bashkëpunimin në kuadër të kryerjes së operacioneve të kërkim - shpëtim në det.

Në ditën e vizitorëve të shquar mori pjesë komandanti i Flotiljes Detare, Pashaliman, kapiten i rangut I Ëngjëll Sinanaj, i cili së bashku me të ftuarit e tjerë dhe komandantët e anijeve pjesëmarrëse në stërvitje u pritën nga komandanti i Divizionit të Dytë Detar, Taranto, kundëradmiral Giacinto Sciandra.



## Operacion SAR nga efektiv i anijes P-134 "Butrinti"

Anija P-134 "Butrinti" gjatë kryerjes së patrullimit dhe stërvitjes paradislokuese për misionin që do zhvillojnë në "Sea Guardian", ka marrë informacion nga QNOD se një mjet detar, pranë Gjirit të Dafinës, po kërkonte ndihmë për shkak të një defekti në motor.

Anija P-134 i ka ardhur në ndihmë menjëherë dhe filloi rimorkimi i mjetit të peshkimit, më pas iu dorëzua policisë kufitare në Triport, Vlorë për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.



## QPR dhe efektivët e FT, zhvilluan në qytetin e Kukësit promovimin e oficerëve dhe ushtarëve në Forcat e Armatosura

Nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, Qendra e Personel Rekrutimit dhe efektivët e Forcës Tokësore, zhvilluan në qytetin e Kukësit promovimin e oficerëve dhe ushtarëve në Forcat e Armatosura.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga organet vendore të qarkut Kukës, Prefekti i Qarkut Kukës z. Ali Hallaci, nënkryetari i Bashkisë Kukës z. Granit Gjana, kryetari i Qarkut Kukës z. Abdullah Domi, drejtori i J9-së, kolonel Arjan Osmani, komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Fadil Ciroku; si dhe përfaqësues nga Ambasada Britanike, zëvendës ambasadorja Mia Marzouk, Atasheu Ushtarak, nënkolonel Timothy Wight-Boycott, zëvendës Atasheu Ushtarak Maj Imran Ahsan dhe përfaqësuesi i Ambasadës së SHBA-s, z. Carl Jeffery Ingram, Këshilltar për rekrutimin.

Qendra e Personel Rekrutimit në bashkëpunim me Forcën Tokësore ishin prezent me standat e tyre me materiale sensibilizuese dhe informuese nga QPR, si dhe me armatime të lehta nga Forca Tokësore. Në këtë aktivitet nuk mungoi dhe Orkestra Frymore e Bandës së Bateristëve të Korpusit Mbretëror të Ushtrisë Britanike.



# Gjeneral brigade Xhebexhia: Suksesi për çdo detyrë kërkon që të afrosh zemrën, mendjen dhe vullnetin në çdo kohë

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

**F**orca Tokësore u krijua më 29 gusht të vitit 2000, duke përfshirë në radhët e saj njësi dhe reparte me traditë me një veprimtari të pasur shumëvjeçare, të përhapura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sot Forca Tokësore është njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura.

Me një përbërje prej 5 divizionesh këmbësorie me rreth 55 brigada dhe 300 batalione në 167 rajone të ndryshme të vendit, Forca Tokësore u përfshi në një proces transformimi të thellë e të gjithanshëm sipas koncepteve të ushtrive perëndimore dhe me kalimin tërësisht të strukturave të kësaj force, nga një ushtri e shërbimit të detyrueshëm në një ushtri profesioniste, duke rritur nivelin e operacionalitetit.

Forca Tokësore është hallka kryesore e FA-së, ajo ka në strukturën e saj, Komandën dhe Shtabin e FT si dhe repartet e nënrepartet me të cilat bën të mundur realizimin e misionit të saj.

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i Forcës Tokësore me një karrierë të gjatë në Forcat e Armatosura, ka nisur rrugëtimin e tij si, komandant toge në Regjimentin Komando, më tej specialist në Seksionin e Analizës, Drejtoria e Zbulimit (J2), në SHPFA, detyra të ndryshme në Drejtorinë e Zbulimit (J2), shef Seksioni (S-2), në qendrën e Radio-Zbulimit (SIGINT), zëvendës komandant i Qendrës së Radio-Zbulimit (SIGINT), Oficer Shtabi për Inteligjencën, përfaqësia Ushtarake Shqiptare në NATO, Bruksel. Shef i Qendrës SIGINT, Agjencia Inteligjencës Ushtarake, Drejtor i Drejtorisë së SIGINT, Agjencia Inteligjencës Ushtarake, shef i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes (G-3/7), Komanda e Forcës Tokësore. Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes J3/7 në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së. Zëvendës Përfaqësues Ushtarak Shqiptar në NATO dhe Atashe i Mbrojtjes për Mbretërinë e Belgjikës dhe jo rezident për Republikën e Francës. Në vitin 2020, gradohet me gradën mëdhorë “gjeneral brigade”, ku do të kryente detyrën si komandant i Forcës Detare, më tej komandant i Komandës Mbështetëse.

**Z. gjeneral, duke mundësuar këtë bashkëbisedim, më jepet rasti të sjell në vëmendje që bashkëpunimi juaj me median ushtarake është i hershëm, si autor apo bashkautor i shkrimeve në revistën “Mbrojtja” dhe në gazetën “Ushtria”. Por, këtë herë tashmë në një pozicion tjetër, dëshirojmë që ju të ndani me ne përvojën tuaj si ushtarak me një eksperiencë mjaft cilësore. Si e vlerësoni ju këtë eksperiencë në FA?**

Ju falënderoj për mundësinë që po më krijoni për të biseduar me gazetën Tuaj kaq të nderuar, respektuar e vlerësuar, si një media pranë dhe për gjithë personelin dhe familjarët e ushtarakëve.



Sigurisht, tashmë që po mbushen 30 vjet e kthen e mendon për vitet që kanë kaluar është e vështirë që të japësh një përgjigje të prerë. Është sa një eksperiencë dhe karrierë si e çdo ushtaraku tjetër po aq edhe specifike me veçori individuale me vështirësi dhe rezultate. Këto 30 vjet nisin atje në vitet e largëta, kur nuk ishim më tepër se 13-14 vjeç të veshur me ngjyrën e gjelbër dhe ecën nëpër rrugë sa të vështirë po aq edhe sfiduese. Ndjehe mirë që rruga ime ka ecur gradualisht nëpër gjithë etapat e karrierës së një ushtaraku deri në rangun që mbaj sot, për të cilën çdo ushtarak e ka një objektiv të synuar. Si vartës e si epror, si koleg e si shok, si individ e si ekip, unë kujtoj jo vetëm detyrat e ndryshme, por edhe bashkudhëtarët që kemi pasur në krahë. Tashmë tani edhe në pozicionin e Komandantit të Forcave Tokësore unë ndjehe sa i vlerësuar po aq edhe i përkushtuar.

**Ju përmendët se gjatë karrierës keni kryer**

**detyra të ndryshme, për një ushtarak në zinxhirin e drejtimit dhe komandimit, si në fushën operacionale ashtu edhe në ato të përfaqësimit. Më herët në Përfaqësinë Ushtarake shqiptare në NATO, Bruksel, dhe më tej zëvendës-përfaqësues ushtarak në NATO, atashe ushtarak i mbrojtjes për Mbretërinë e Belgjikës dhe jo-rezident për Republikën e Francës, etj. Çfarë do të thotë për një ushtarak kur kryen këto detyra jashtë vendit në aspektin e përfaqësimit të FA-së?**

Vërtet është një numër i larmishëm detyrash, ku çdo njëra ka veçoritë e veta dhe dallon jo pak nga të tjerat. Pavarësisht se secila kërkon angazhim serioz dhe përkushtim të veçantë ato në çdo kohë përfaqësojnë sfida. Sigurisht që një detyrë operacionale nga një detyrë përfaqësimi dallojnë mjaft, sepse ndërsa në të parën aftësitë qëndrojnë veçanërisht në organizim dhe drejtim, në të dytën (përfaqësim) sfidat bëhen edhe më të mëdha, sepse ballafaqohesh në përfaqësimin

e Forcave të Armatosura dhe të vetë shtetit. E ndërsa e para të jep mundësinë e rishikimit dhe përmirësimit, e dyta nuk të lejon të gabohesh në asnjë rast, sepse mundësia vjen vetëm njëherë.

**Duke u ndalur në detyrat që keni kryer së fundmi, z. gjeneral, ju keni pasur shansin dhe sfidën të keni qenë në pozicionin e drejtuesit si Komandant i Forcës Detare, më pas Komandant i Komandës Mbështetëse dhe aktualisht Komandant i Forcës Tokësore. Cilën shihni si të përbashkëtën dhe dallimin midis tyre, apo edhe më tepër, me përvojën e një drejtuesi, cila detyrë është më ‘pranë zemrës’ tuaj, nëse krahasojmë?**

Çdo detyrë ka specifikat e veta, por edhe karakteristika të përbashkëta. Çdo njëra prej tyre, nëse kërkon ta realizosh cilësisht kërkon përkushtim dhe më tepër se individualitet



kërkon punë në grup. Asnjë detyrë nuk realizohet individualisht por në gjithë zinxhirin e komandimit që nga niveli më i lartë e deri te ushtari apo punonjësi që ndodhet në pozicionin më të thjeshtë. Dallimet sigurisht që ekzistojnë, por ndoshta janë ato që e bëjnë edhe më interesant angazhimin. Dhe sigurisht që krahas vështirësive sot më jepet mundësia që të ndjehem edhe më afër për gjithë angazhimet që kanë forcat e armatosura, pavarësisht llojeve të tyre. Sa për ‘zemrën’ do të thosha që suksesi për çdo detyrë kërkon që të afrosh ‘zemrën’, mendjen dhe vullnetin në çdo kohë.

**Ne e njohim vendin dhe rolin që luajnë Forcat Tokësore në strukturat e FA-së. Cilat mendoni ju, se janë disa nga detyrat kryesore me të cilat po angazhohen FT?**

Në respekt edhe të forcave të tjera, por edhe gjithë strukturave të FA-së, Forcat Tokësore mbajnë sot peshën më të madhe me detyra nga më të rëndësishmet, që nga zhvillimi dhe ruajtja e kapaciteteve për një nivel sa më të lartë gatishmërie, kjo jo vetëm për misionin e tyre por edhe për situatën mjaft delikate në rajonin tonë. Por detyrat tona nuk kufizohen vetëm në operacione, por edhe në detyra të tjera ku spikat ndihma ndaj komunitetit, veçanërisht në emergjencat civile, në rast fatkeqësish natyrore apo humane: që nga tërmete, përmbytje, zjarre avari të ndryshme në infrastrukturë e të tjera, pavarësisht nga koha dhe vendi. Po aq të rëndësishme janë edhe angazhimet në misione në kuadrin e aleancave e partnershipeve e veçanërisht që lidhen me NATO-n, BE-në, OKB-në e të tjera.

**Duke hyrë pak më thellë në strukturën e Forcës Tokësore: Komandën dhe Shtabin e FT apo dhe repartet e nënrepartet, me të cilat ajo bën të mundur realizimin e misionit të saj. A mund të veçojmë një strukturë si më specifike?**

Me këtë pyetje ju më dhatë mundësinë që unë të përshëndes gjithë strukturat e Forcave Tokësore që nga Shtabi e deri në njësitë më të thjeshta, për punën e tyre cilësore, angazhimin e tyre të plotë dhe besimin që të realizojnë çdo detyrë pavarësisht nga shkalla e vështirësisë. FT punojnë si një zinxhir dhe mund të jenë të suksesshme vetëm si të tilla. Drejtues, ushtarë e punonjës janë po aq të rëndësishëm në misionin dhe detyrat që kemi apo që na afrohen në çdo kohë. Ato janë të veçanta në strukturë, apo në përbërje por të njëjta në rëndësi për misionin që kemi.

**Kalendari juaj i stërvitjeve duket mjaft dinamik. A do të veçonit disa prej tyre?**

Është e vërtetë që Forcat Tokësore kanë një kalendar nga më të ngjeshurit për stërvitje si forcë apo në kontekstin multinacional. Ndërsa në stërvitjet brenda vendit, fokusi kryesor janë stërvitjet dimërore, ujore dhe malore me kohëzgjatje të ndryshme. Në stërvitje multinacionale do të veçoja DEFENDER EUROPE 23, ku FARSH kishin një rol të veçantë specifikisht në TFS (Task Force South) dhe kam kënaqësinë t’ju informoj se e përfunduan cilësisht dhe me një angazhim dinjitoz së bashku me aleatët.

**Ju përmendët më lart që FT trajnon dhe merr pjesë me trupa në misionet e mbështetjes së paqes në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së apo edhe në formate të tjera. Në çfarë raporti i vendosni ju këto forca krahasuar me homologët e tyre?**

Nuk do të mjaftonte vetëm se si i vlerësojmë ne standardet që ato kanë arritur. Kontingjentet tona pa asnjë dallim pas stërvitjeve janë angazhuar për vite në mjaft operacione së bashku me aleatët, për të cilat kanë marrë prej tyre vlerësimet më cilësore jo vetëm për aftësi por edhe për përkushtim. Kjo i

referohet standardit mjaft të lartë të stërvitjeve, me norma të njëjta me ato të angazhimit si edhe partnerët tanë. Ne jemi optimistë se, duke u bazuar në standarde të tilla në do të jemi në të njëjtin nivel në të gjitha operacionet dhe stërvitjet e përbashkëta.

**Cila është stërvitja e radhës dhe a jeni në koordinim edhe me strukturat e tjera të FA-së?**

Çdo vit vendet e Ballkanit organizojnë stërvitjen “Strong Balkan” ku pjesëmarrja e personelit të FT-së është e pandërprerë. Këtë vit ne jemi vendi organizator (mikpritës) për këtë stërvitje me pjesëmarrjen e 9 vendeve. Jam i sigurt që do të realizojmë me sukses këtë përgjegjësi, ku fokusi kryesor do të jetë shkëmbimi i eksperiencave në mbështetje të paqes në Ballkan dhe përforsimi i bashkëpunimit dhe operacionalitetit.

Ndërsa për sa i përket bashkëveprimit me strukturat e tjera është dinamik me ndjenjë të përbashkët përgjegjësie e cila na jep edhe më tepër mundësi për sukses. Forca Tokësore është një nga strukturat më të suksesshme në dhënien e ndihmës së parë të popullsisë në përballimin e fatkeqësive natyrore me një mision sa mbresëlënës aq dhe frymëzues. Është e vërtetë që ndihma e popullsisë na gjen të parët në përballimin e rrezikut. Njësitë

**Me një përbërje prej 5 divizioneve këmbësorie me rreth 55 brigada dhe 300 batalione në 167 rajone të ndryshme të vendit, Forca Tokësore u përfshi në një proces transformimi të thellë e të gjithanshëm sipas koncepteve të ushtrive perëndimore dhe me kalimin tërësisht të strukturave të kësaj force, nga një ushtri e shërbimit të detyrueshëm në një ushtri profesioniste, duke rritur nivelin e operacionalitetit.**

tona i gjen në çdo kohë të motit dhe të terrenit pranë popullsisë dhe për këtë kemi marrë edhe vlerësimet më të mira nga strukturat qendrore dhe lokale të qeverisjes, por veçanërisht të vetë popullsisë në zonat e rrezikuara. Ne përgatitemi për këto detyra dhe kapërcejmë vështirësitë në çdo situatë. Për ne mbetet një detyrë e përhershme.

**Zoti gjeneral, që në fillim të intervistës përmendëm bashkëpunimin tuaj me median ushtarake. Ne ju gjemë në një numër titujsh si “Liria e Irakut” në 2006 dhe “Proceset integruese të Evropës Juglindore” në 2007, por edhe si autor dhe bashkautor në librin e botuar nga Universiteti Kombëtar i Inteligjencës në SHBA dhe Agjencia e Inteligjencës Ushtarake Shqiptare. Është pasion kjo fushë?**

Pavarësisht se detyrat e ndryshme kanë qenë operacionale dhe kanë kërkuar mjaft kohë, përsëri mendoj se të gjithë ushtarakët duhet të jenë e të angazhohen me librin, si një nga miqtë dhe këshilltarët më të mirë. Sigurisht që pasioni ka rolin e vet, por edhe vullneti duhet të jetë pjesë e këtij angazhimi. Edhe njëherë ju falënderoj ju si media në nxitjen e këtij pasioni dhe në pasqyrimin që i bëni gjithë angazhimit të Forcave të Armatosura.



# QPR, "struktura port ku hyn gjaku i ri" në FA

**R**eformimi i Forcave të Armatosura në kuadër të anëtarësimit në NATO dhe standardizimi i tyre strukturor çoi në krijimin e një strukture të re personeli, Qendrën e Personel Rekrutimit, e cila do të kishte si mision rekrutimin e ushtarëve aktivë dhe administrimin e dosjeve të personelit ushtarak të Forcave të Armatosura. Në vijimësi, misioni dhe detyrat e Qendrës së Personel Rekrutimit kanë evoluuar në funksion të strukturës dhe ndryshimeve ligjore të ndodhura në FA.

Misioni i kësaj qendre është rekrutimi i kandidatëve për oficerë e ushtarë/detarë aktivë, promovimi dhe informimi i publikut, përpunimi dhe administrimi i dokumentacionit dhe i të dhënave të personelit të ushtarakëve aktivë dhe atij në rezervë/lirim, realizimi i trajtimit financiar të ushtarakëve në rezervë/lirim si dhe vënia në efikasitet e burimeve njerëzore dhe materiale në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Qendra e Personel Rekrutimit e filloi veprimtarinë e saj, më 22 qershor të vitit 2007, si një domosdoshmëri e zhvillimit të Forcave të Armatosura, me një mision mjaft domethënës siç është ai i menaxhimit të ciklit jetësor të burimeve njerëzore të FA-së. Sot, mund të thuhet se QPR zhvillon një proces rekrutimi, i cili garanton që Forcat e Armatosura shqiptare të kenë në gjirin e tyre një brez të ri, që është në gjendje të kryejë më së miri të gjitha detyrat në përmbushje të misionit kushtetues brenda vendit, ashtu dhe detyrimet në shërbim të paqes kudo në botë, në kuadër të Aleancës dhe strukturave të tjera ndërkombëtare. Kjo qendër, nëpërmjet programit të automatizimit të të dhënave të personelit aktiv, bën të mundur administrimin e tyre në sistem me mjaft kujdes e transparencë, përkushtim e profesionalizëm, gjë e cila është baza e ecurisë në karrierë të personelit të FA-së.

Administrimi i të gjitha dosjeve të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe i të dhënave të kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak në QPR të të gjithë shtetasve meshkuj në vend, ka rritur më tej rëndësinë dhe përgjegjësinë e saj. Por QPR bashkëpunon gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Qarqe, Postën Shqiptare në të gjithë vendin, pushtetin qendror dhe vendor si dhe të gjitha institucionet e tjera brenda dhe jashtë FA-së, me qëllimin e vetëm për të garantuar një shërbim sa më cilësor për ish-ushtarakët si dhe atyre që ia kushtuan karrierën FA-së. Personeli i QPR-së i shërben në kohë reale kësaj kategorie ushtarakësh pa vonesë, me cilësi, profesionalizëm dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie, duke bërë të gjitha përpjekjet që procedurat burokratike të lehtësohen në maksimum në interes të tyre.

Në këto 16 vjet, misioni dhe detyrat themelore të QPR-së kanë ardhur duke u zgjeruar dhe konsoliduar. Numri i personelit të qendrës është dyfishuar dhe ajo tani shtrihet në gjithë hartën e Shqipërisë. Në të 12 qarqet e vendit u ngritën seksionet e rekrutim-mobilizimit, të cilat jo vetëm përmirësojnë procesin e rekrutimit të brezit të ri si kontingjent i FA-së, por më e rëndësishmja, ato janë themeli dhe baza e krijimit dhe zhvillimit të komponentit të rezervës, e cila tashmë është një sfidë jo vetëm për QPR, por për vetë Forcat tona të Armatosura.

Duke shkruar për këtë strukturë kaq të



rëndësishme, që nga krijimi e deri më sot s'mund të lëmë pa përmendur personelin e QPR-së dhe drejtuesit e saj ushtarak ndër vite, që me punën e tyre kanë bërë të mundur përmbushjen më së miri të detyrave dhe misionit të kësaj qendre. Punonjës ushtarakë dhe civilë janë në një bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA-së. Kanë qenë pikërisht këto dy shtylla të rëndësishme institucionale që me përkujdesjen e vazhdueshme të tyre, kanë mbështetur vazhdimisht gjithë veprimtarinë e QPR-së, madje ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, shpesh e ka bërë pjesë të axhendës së tij në takime të ndryshme promovuese aspektin për rekrutët e rinj në qarqe e rrethe si dhe në aktivitete të tjera të qendrës.

## **QPR, domosdoshmëri e menaxhimit të ciklit jetësor të Burimeve Njerëzore të FA-së**

Qendra e Personel Rekrutimit është një strukturë me shumë rëndësi në fushën e administratës shtetërore. Ajo u krijua si domosdoshmëri e disa faktorëve teknikë dhe politikë nëpër të cilët po kalonte vendi. "Para vitit 2007, rekrutimi ishte bërë problematik në ushtrinë dhe vendin tonë. Degët ushtarake ose qendrat e rekrutimit kishin shumë vështirësi në misionin e tyre dhe në atë kohë merrnim me polici ushtarë për të ruajtur repartet ushtarake. Kjo mënyrë krijoi

probleme në vijimësi", shprehen ish drejtuesit e QPR-së.

Nga ana tjetër, evidenca ushtarake pësoi një vakum për faktin se një pjesë e madhe i shmangeshin shërbimit ushtarak dhe një pjesë kishin ikur refugjatë dhe ishte e pamundur të vijohej ende me atë ligj. U shtrua problemi i menaxhimit të të dhënave të personelit, i cili kishte krijuar informacione të një abuzimi të mundshëm dhe mos administrimi të saktë në atë kohë. Në këto kushte, MM dhe SHP bëri një administrim të ligjit ekzistues të shërbimit ushtarak dhe gradualisht filloi të ndërtonte një ligj të ri të ushtarit profesionist.

Në vitin 2007, në prag të hyrjes në NATO, ushtria jonë ishte 100% profesioniste. "Në atë kohë misioni i kësaj qendre personeli ishte i dyanshëm, - kujtojnë drejtuesit e parëve të qendrës, - pasi së pari qendra duhet të bënte rekrutimin, por kësaj radhe rekrutim profesionist, ushtarë profesionistë dhe studentë për shkollat e larta dhe së dyti të bënte administrimin e të dhënave të personelit". Në ato vite, përveç fushës së rekrutimit të ushtarëve profesionistë, u menaxhuan jo vetëm të dhënat e personelit aktiv dhe atij në rezervë, por u krijuan edhe kartotekat nëpër reparte për nënoficerin dhe ushtarin profesionist si dhe personelin civil, detyra që shkuan drejt automatizimit dhe sot funksionojnë

në mënyrë perfekte.

Drejtuesit e kësaj strukture kanë tentuar të rrisin autoritetin e kësaj strukture të re, jo vetëm brenda FA-së, por veçanërisht në pushtetin vendor, duke bërë një fushatë të gjerë marketingu. Ata kanë arritur të krijojnë një strukturë të re të menaxhimit duke ruajtur strukturat e kartotekave, veçanërisht të nënoficerit dhe të ushtarit profesionist si strukturë e re. Nga ana tjetër, u transformuan degët ushtarake në përputhje me misionin e ri që po merrte ushtria. Në tërësi, u krijuan përshkrimet e para të detyrës, rregulloret e para dhe u ngrit profili i një qendre, e cila do të ishte kjo e sotmja. Gjithashtu një kontribut të vazhdueshëm ka dhënë ekipi amerikan i CUBIC për vizionin dhe strukturën e QPR-së. Nga ana tjetër, QPR është "struktura port ku hyn gjaku i ri" në FA dhe si e tillë ka mjaft rëndësi për menaxhimin dhe administrimin e të dhënave të të gjithë personelit apo efektivit të FA-së dhe mbi të gjitha në procesin e karrierës dhe në marrëdhënien njerëzore, shpirtërore apo shërbyese që ka me të gjithë ushtarakët në rezervë dhe lirim. Rrugëtimi i QPR-së ka ardhur duke shënuar progres, sidomos në shpejtësinë e saktësinë e shërbimit duke vënë theksin mbi komponentin rezervist, i cili ka marrë një rëndësi reale dhe në këtë kuadër QPR ka rol primar, sidomos me degët e saj në rrethe, qendrat e mobilizimit të rezervistëve në qarqe, 12 të tillë. Kjo e ka dyfishuar numrin e personelit dhe ka përmirësuar më tej nivelin e shërbimit të punës të funksionimit të kësaj qendre, sigurisht duke i shërbyer detyrave dhe misioneve që ka FA.

## **Arritjet e QPR-së ndër vite**

Përqendrimi në kartotekën e QPR-së i dosjeve të ushtarakëve në rezervë/lirim, përqendrimi i të dhënave të SHDUA, përgatitja e procedurave standarde të pranimit, administrimit, kërkesave që kanë shtetasit për pajisjen me vërtetim për SHDUA si dhe përgatitja e dokumentacionit për përfutimet suplementare për ushtarakët në rezervë dhe lirim, janë arritje të QPR në këto 16 vjet. "Përpunimi i dokumentacionit të ushtarakëve për përfutime suplementare bëhet brenda afateve të përcaktuara jo vetëm pranë Drejtorive



Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Qarqe (ISSH 12 drejtori), por dhe qytetarëve nëpërmjet shërbimit postar si dhe takimit të drejtpërdrejtë në zyrat e institucionit tonë, duke bërë jo vetëm ballafaqimin me të dhënat në dosjen e tyre personale, por dhe sqarime të nevojshme kur ka paqartësi nga ana e tyre”, thotë zëvendëskomandanti i QPR-së nënkolonel Aleks Rapi.

Shërbimi që ofrohej brenda 2-3 ditëve nga mbërritja e kërkesës së qytetarit nëpërmjet Postës Shqiptare, sot në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, urdhrit të Kryeministrit nr. 153, datë 25.11.20199 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 1.1.2020”, ofrimi i shërbimeve nga Qendra e Personel Rekrutimit për përpunimin e dokumentacionit për përkujdesje e përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim, realizohen vetëm elektronikisht nëpërmjet platformës “e-Albania”, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me nënshkrim elektronik, thekson nënkolonel Rapi. “Në QPR, - tha ai, - nuk janë të pakta rastet kur qytetarët vijnë enkas për të takuar personelin tonë për t’i falënderuar në shenjë respekti e mirënjohjeje”.

Në këtë institucion bëhet hedhja e të dhënave të personelit të FA-së, në programin e ri të automatizimit të të dhënave të personelit të FA-së, përgatitja dhe vënia në dispozicion të komisioneve të karrierës, i dokumentacionit të kandidatëve për t’u shqyrtuar për marrjen e gradës dhe kryerjen e kursit institucional të radhës, bazuar në të dhënat e informatizuara; dërgimi në MM e SHPFA (sipas fazave), i listave të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve/detarëve aktivë sipas gradave që plotësojnë kohën e qëndrimit në shërbim aktiv në FA (me moshë); realizimi i planit të rekrutimit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së; krijimi i një databaze me të dhëna të detajuara për



ushtarakët (oficer, nënoficer dhe UP) në rezervë/lirim/pension; përgatitja e dokumentacionit për përfitimet e suplementare (modulari nr. 03), lirim e pension, vërtetimeve për vjetërsinë në shërbim në FA (modulari nr. 31) si dhe vërtetimit për pagën; vërtetim për vjetërsi në shërbim dhe pagën mesatare referuese neto Modulari Nr. 03; për efekt pensioni, vjetërsi shërbimi invaliditeti ose familjar (për ushtarakët në rezervë/lirim për efekt pensioni pleqërie, Modulari Nr. 31); për pagën referuese për periudhën e trajtimit financiar të ushtarakëve sipas VKM nr. 225, datë 29.05.1992 dhe VKM nr. 07, datë 10.01.1996; Vërtetime karriere për personelin ushtarak në R/L/P si dhe vërtetime vjetërsie në punë për personelin civil; hartimi i përshkrimit të punës për personelin e Qendrës së Personel Rekrutimit; Përgatitja e planit të veprimit “Për Marketingun”, përditësimi në dosjet personale dhe në databazë i Urdhrave të Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit

të Përgjithshëm i FA-së si dhe të Komandantëve të Forcave për emërim në detyrë të personelit të FA-së, sipas strukturës së re.

QPR vitet e fundit ka përmirësuar shërbimin ndaj shtetasve, plotësimin në kohë të kërkesave për pajisje me vërtetim SHDUA dhe të dokumentacionit për përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim/pension. Ajo njëkohësisht vazhdon me standardizimin, automatizimin, administrimin dhe përditësimin e të dhënave të personelit aktiv në FA dhe atij në R/L; koordinimin me njësitë e repartet e FA-së, me qëllim realizimin e procedurave për sigurimin e mundësive dhe shanseve të barabarta të kandidatëve për të shërbyer në FA, pavarësisht përkatësisë fetare, krahinore, etj.

QPR po vazhdon zbatimin e masave konkrete për promovimin dhe informimin e publikut (zhvillimi i marketingut), për rekrutimin e kontingjenteve në interes të FA-së. Bashkëpunimi me organet e pushtetit vendor, zyrat e punës dhe institucionet arsimore në të gjitha prefekturat, për promovimin dhe rekrutimin është pjesë e punë në vazhdimësi. Një drejtim tjetër i rëndësishëm i Qendrës së Personel Rekrutimit është administrimi, menaxhimi dhe përditësimi i të dhënave në dosjet personale dhe në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për personelin ushtarak dhe civil aktiv në Forcat e Armatosura.

Përmeshja e misionit mbështetet në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore, rregulloreve e procedurave standarde dhe falë kontributit të dhënë nga kompania amerikane SAIC/CUBIC, u bë e mundur vënia në efikasitet në vitin 2012 i programit të automatizimit të të dhënave (SMBNJ) të personelit aktiv. Të gjitha këto të dhëna të administruara në sistem, i shërbejnë më së miri menaxhimit të personelit nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura si dhe komisioneve të karrierës për mbarrëvajtjen e procesit të shqyrtimit të personelit ushtarak për promovimin e tyre dhe ecurinë në karrierën ushtarake.

Përkujdesja ndaj ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe familjeve të tyre, është një drejtim

me shumë rëndësi i Qendrës së Personel Rekrutimit. Përqendrimi i të gjitha dosjeve të ushtarakëve të kësaj kategorie, rreth 55.000 dosje si dhe i procedurave për pasqyrimin në dokumentet e kërkuara për të gjitha llojet e pensione dhe përfitimeve suplementare, e ka bërë shumë të vlefshme punën e personelit, duke i dhënë më shumë cilësi, shpejtësi dhe transparencë trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesave të kësaj moshe. Administrimi i të dhënave për kryerjen e Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak Aktiv i rreth 1.700.000 shtetasve shqiptarë meshkuj, në Qendrën e Personel Rekrutimit si dhe ofrimi i këtij shërbimi publik pa pagesë brenda 2-3 ditëve, ka bërë që të njihet e vlerësohet nga shtetasit dhe institucionet shtetërore në vend. Personeli i kësaj qendre është gjithmonë në dispozicion të të gjithë qytetarëve të cilët hasin vështirësi të ndryshme, duke i dhënë zgjidhje sa më të shpejt problematikave të tyre. Përvoja e ofrimit të shërbimeve sa më afër publikut, pranë



# Luiza Gega, krenari dhe aset kombëtar

Luiza Gega, pjesë e Forcave të Armatosura, me gradën honorifike “kolonel”, vazhdon të sjellë në atdheun e saj, kupa fitoreje, siç ishte dhe ajo e Kampionatit European Ekipor të atletikës, ku atletja shqiptare ka triumfuar.

Sportistja jonë ka mposhtur Salpeter, duke marrë kështu pikët maksimale në garën e 5000 metrave për femra.

Kampionia shqiptare ka lënë pas gjithë kundërshtarët, me kohën 15:32.39, rreth 4 sekonda më e shpejtë se rivalja Salpeter nga Izraeli.

Ajo mban rekordin në vrapimin 800, 1500 dhe 3000 metra.

Arritjet e saj janë: Kampionati European Paris 2011 në 800 metra, me rezultatin 2:08:34 sekonda, Kampionati Botëror Koreja 2011 në 800 m, vendi 20 me rezultatin 2:03”11 sekonda, Kampionati Ballkanik (Indoor) Stamboll, në 1500 m, vendi parë, medalje ari, me rezultatin 4:10:75 sekonda.

Luiza Gega nderoi kombin dhe Forcat e Armatosura, duke valëvitur lart me krenari flamurin kuq e zi.

çdo zyre postare, por dhe tashmë aplikimi online në e Albania, kanë bërë të mundur rritjen e cilësisë së shërbimit, aplikimin dhe marrjen e përgjigjeve dhe dokumentacionit të nevojshëm nga ana e qytetarëve.

Risi e misionit dhe e detyrave të strukturës aktuale të Qendrës së Personel Rekrutimit është dhe krijimi i komponentit të rezervës, i domosdoshëm jo vetëm si përvojë e vendeve të Aleancës ku aderojmë, por dhe për t’u ardhur në ndihmë e për t’u përdorur në përballimin e situatave emergjente në zona të ndryshme në vend. Ngritja dhe funksionimi i strukturës së komponentit të rekrutimit për ushtarakët aktivë e ata të rezervës në 12 qarqet e vendit si dhe për Forcat e Komandat, bën të mundur sigurimin e burimeve njerëzore e materiale, kur kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme, lidhjen dhe bashkëpunimin e ngushtë së Forcave të Armatosura me organet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera publike e jopublike.

## Rekrutimi, sfida përballë qendrës

Rekrutimi si një nga detyrat bazë të kësaj qendre, fokusohet në kryerjen e fushatave të promovimit dhe informimit të grupeve të interesit dhe individëve mbi mundësitë që ofrojnë FA-të për një karrierë të sigurt dhe një jetë më të mirë për të rinjtë dhe të rejtat që dëshirojnë të bëhen pjesë e saj. Bazë për rekrutimin e oficerëve të rinj, ushtarit/detarit aktiv janë kriteret ligjore të përcaktuara si dhe politikat e rekrutimit të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes.

Ai kryhet sipas planit dhe nevojave të Forcave të Armatosura, duke i dhënë përparësi rekrutimit të shtetasve me arsim të lartë dhe me aftësi të

mira për specialitete të veçanta. Vlen të theksohet që shpeshherë përfaqësuesit më të lartë civilë dhe ushtarakë kanë qenë pjesë e takimeve të zhvilluara në institucionet arsimore të vendit. Kandidatët të regjistruar me dokumentacion të rregullt i nënshtrohen testeve fizike, intelektuale dhe psikologjike. Qendra e personel Rekrutimit është angazhuar gjithmonë të zbatojë me përpikëri dhe transparencë të gjitha procedurat ligjore për përzgjedhjen e kandidatëve më cilësorë për realizimin e planit të rekrutimit.

Ajo vepron në bazë të një programi të caktuar 6-mujor, ku për 6-mujorin e dytë 2023, ka në plan të rekrutojë 439 personel. Me gjithë angazhimin e bërë gjatë fushatave të rekrutimit, marketingut të zhvilluar gjatë kohëve të fundit, rritjes reale/shtesës së pagave të ushtarakëve aktiv në Forcat e Armatosura me 30% nga data 1 korrik 2022, si dhe me 7 % nga marsi i këtij viti, realizimi i planit të rekrutimit nuk ishte në nivelin e kërkuar. Si probleme, e evidentuar është tendenca e lëvizjes së të rinjve për mundësi më të mira jashtë vendit, i cili është dhe burimi kryesor për rekrutim në FA. “Duke analizuar situatën e rekrutimit në FA, lind nevoja e kryerjes së një studimi të thelluar, me ndryshimet e nevojshme ligjore ku mund të përdoren të dyja format e rekrutimit: vullnetar dhe fillimin e atij me detyrim, duke përcaktuar moshën e rekrutimit dhe kohë/afate të tjera rekrutuese nga ligji aktual nr. 9047, datë 10.07.2003, në vartësi të numrit përgjithshëm të personelit në FA e të situatave rajonale”, specifikon zëvendëskomandanti i QPR-së, nënkolonel Aleks Rapi.



VETERAN I ARMËS SË TANKEVE,  
MYFIT METANI

### Fillesat e organizimit të Armës së Tankeve...

Fillimisht struktura më e lartë organizative e armës së tankeve ishte Dega e Tankeve me shef Adnan Qatipin në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë. Në përbërje ajo kishte instruktor për taktikën, zjarrin e teknikën. Dega e Tankeve në momentet e para u ndesh me shumë probleme të strukturës organizative, të vendvendosjes (rajonet e përqendrimit), të drejtimeve të përdorimit e të detyrave të armës së tankeve në llojet e luftimit në bashkëveprim me këmbësorinë, artilerinë etj. Sipas artit ushtarak të kohës, detyra për ndërtimin e strehimeve nëntokësore (tuneleve) e vendosjen e teknikës së tankeve në to, krijimin e kushteve për efektivin për jetesë e stërvitje etj. Dega e Tankeve zgjidhi më së miri problemet momentale. Në vitet 1946-1960 Arma e Tankeve u pajis me tanke T-34. U krijuan njëri pas tjetrit reparte tankiste (batalione tankesh-bt.) në Zall Herr të Tiranës me komandant batalioni Estref Musabelliu, në Shkodër, në Elbasan me komandant batalioni Aleko Koka, në Berat me komandant batalioni Loni Kristo (fillimisht Demo Liço), në Korçë me komandant batalioni Shefqet Dini, në Gjirokastrë, në Fier me komandant batalioni Demo Liço. Në vendet e vendosjes së reparteve mungonin kushtet më minimale të jetesës e stërvitjes. Niveli e mjeshhtëria e drejtimit të komandantëve, në kohë rekord e ndryshuan gjendjen. Fillimisht krijuan kushtet e nevojshme minimale për jetesë e stërvitje e në vijimësi shumë reparte u bënë model në ushtri. Batalionet e tankeve me 31 tanke përbëheshin nga tri kompani tankesh me nga 10 tanke secila. Kompanitë e tankeve me 10 tanke nga tri toga tankesh me nga 3 tanke secila dhe një tank i komandantit të kompanisë.

### Për një staf më cilësor

Pas viteve 1960 Arma e Tankeve mori një zhvillim në historinë e saj. Para drejtuesve të tankeve në Shtabin e Përgjithshëm të ushtrisë dolën një sërë detyrash, që kërkonin staf të madh e cilësor për t'i zgjidhur. Në vitin 1965 Dega e Tankeve u bë komandë e tankeve dhe mjeteve të blinduara me komandant Abas Fejzo. Ai nuk ishte tankist, por me specialitetin e tankeve bëri shumë për armën që drejtonte. Kur drejtoi Brigadën e Parë të Tankeve në Zall Herr të Tiranës nga viti 1960 e bëri model në ushtri për jetesën dhe stërvitjen. Ndërsa vetë mori dhe patentën për guidimin e tankut e të transportuesit të blinduar. Me punën dhe autoritetin e tij, Abaz Fejzo e ngriti Armën e Tankeve në majat më të larta në historinë e saj. Kjo periudhë coincidoi edhe me krijimin e një varg Br.T e bt. në të gjithë Shqipërinë. Për të përballuar një mori detyrash në vijimësi, Abaz Fejzo krijoi një staf me kuadro me integritet, me moral e nivel të lartë profesional, përgatitje e eksperiencë të gjatë në punë si Loni Kriston në degën operative, Astrit Çobani në teknikë, etj.

Për komandën e tankeve dhe mjeteve të blinduara detyrat më parësore ishin: caktimi i rajoneve të përqendrimit (dislokimi, vendvendosja) të njërive dhe reparteve të formuara e në formim e sipër. Formulimin e detyrave luftarake të Br.T dhe bt. në të gjithë territorin e republikës, në përputhje me planin strategjik të mbrojtjes së vendit sipas kriterëve të AUP për përdorimin e tankeve në llojet e luftimit. Grupi i punës i formuar për këtë qëllim punoi me përkushtim me dhe pa orar. Saktësuan dhe eksperimentuan me tanke në terren me detaje çdo element të detyrave luftarake të njërive e reparteve në çdo lloj përdorimi e luftimi të tankeve të përcaktuara në AUP. Punohej në zyrën e punës për hedhjen në hartë të varianteve të

# Arma e Tankeve në rrugëtimin e saj historik



detyrave të çdo njësie e reparteve tankiste në të gjithë vendin. Kur një nga pjesëtarët e grupit të punës të drejtorisë operative të Shtabit të Përgjithshëm, gjendet në zyrën e hartave të tankeve dhe midis të tjerave iu thotë se: “Kjo shigjeta që ju keni hedhur në hartë duhet këtu dhe jo aty ku e keni hedhur ju”. Në këtë kohë Abaz Fejzo e dëgjon këtë ndërhyrje të përfaqësuesit të drejtorisë operative dhe i thotë: “Jemi ne që vendosim për përdorimin taktik të tankeve se jemi specialistë të tyre dhe jo ju”. Më pas komandanti i Tankeve dhe Mjeteve të Blinduara Abaz Fejzo ia tregoi ndodhinë Petrit Dumes, i cili e vlerësoi mendimin e komandantit. Këtë ndodhi e mësuan tankistët dhe vlerësuan komandantin për mbrojtjen e merituar të Armës së Tankeve. Sa kohë në detyrë ishte Abaz Fejzo komandant i Tankeve dhe Mjeteve të Blinduara, arma e tankeve ishte në rolin që i takonte, sepse ishte forcë goditëse kryesore e forcave tokësore.

### Arma e tankeve hap kurs në Akademi

Më pas u bënë ndryshime të jashtëzakonshme. Më 1 shtator 1971 në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm u hap për herë të parë në historinë e armës së tankeve kursi për tanke. Myfit Metani në moshën 27 vjeç kishte një gëzim, sepse ishte akademisti i parë i këtij kursi. Në këtë kurs akademistët tankistë u aftësuan në mënyrë profesionale nga pedagogët e talentuar tankistë si Loni Kristo, Dino Brati, Koli Koçollari etj., në taktikën e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit, në mësimje, mbrojtje, në luftimin kundër desantit ajror, në marshim me parashikim luftimi ndeshës, etj. Ndërsa nga tekniku tankist më kompetenti në zanat Dhimitër Mitrushi, mësuan për herë të parë taktikën e sigurimit teknik të njërive dhe reparteve tankiste. Ky kurs profesional u dha mundësi kuadrove tankistë të argumentonin më me kompetencë e ta konkretizonin më së miri në terren me efektivin, artin e përdorimit taktik të tankeve në llojet e luftimit. Kursi i radhiti në njohuri të AUP me këmbësorët, artiljerët, xhenierët etj., duke rritur autoritetin e kuadrove të tankeve. Tankistët në këtë proces vendosnin vet për taktikën e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit dhe evitonin me kompetencë çdo ndërhyrje të specialiteteve të tjerë.

Me mbarimin e kursit për tanke në akademi, Myfit Metani emërohet shef i Shtabit në Br.T në Korçë. Të parën detyrë që bëri ishte kontrolli i planeve të luftës për përdorimin e BrT në llojet e luftimit. U çudit dhe u habit, për përdorimin e Br.T në mësimje në drejtimin të Qafë e Qarrit - Ersekë. Ishte planëzuar të përdorej në krahun e majtë të rrugës automobilistike Qafë e Qarrit - Ersekë, drejtim ku nuk kalon dhe dhia. Ai planëzim ishte bërë nga dega operative e shtabit të DK të Korçës para hapjes së kursit për tanket në Akademi, duke ia dhënë shtabit të Br.T për ta zbatuar. Ndaj dhe e filloi punën për përdorimin e Br.T në luftim, sepse kishte mbaruar akademinë për artin e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit. Për këtë mangësi vuri në dijen shefin e Shtabit të divizionit Izet Murati. Ai e dëgjoi me vëmendje dhe i vuri detyrë të korrigjonte jo vetëm këtë mangësi, por të shikonte të gjithë planin luftarak të Br.T dhe të bënte korrigjimet e nevojshme.

Pas ribëri planin luftarak të Br.T e miratoi në shtabin e DK dhe menjëherë saktësoi detyrat për shtabin e Br.T, komandat e shtabet e reparteve e nënrepartet dhe të efektivit. Ky saktësim i planit luftarak u rishikua, u riparua dhe u reflektua në të gjitha njësitë e repartet tankiste.

### Organika e tankeve dhe mjeteve të blinduara

Autoriteti i Armës së Tankeve, në vitet 1965-1974, u ngrit në majat më të larta. Ajo u kthye nga degë në komandë të tankeve dhe mjeteve të blinduara me komandant Abaz Fejzo. Gjatë kësaj kohe u krijua një varg Br.T dhe bt. në qytetet më kryesore të vendit. Organika e

Br.T fillimisht përbëhej nga tri batalione tankesh me nga 31 tanke secili dhe një tank i komandantit të brigadës. Shuma e përgjithshme 94 tanke. Në të pastajmen organika e Br.T përbëhej nga tri batalione tankesh me nga 22 tanke secili dhe një tank i komandantit të Br.T. Shuma e përgjithshme ishte 67 tanke. Zvogëlimi i sasisë së numrit të tankeve në Br.T ndodhi se kompanitë e tankeve në batalionet e tankeve me organikë u bënë me nga dy toga tankesh me nga 3 tanke secila dhe një tank i komandantit të kompanisë (gjithsej 7 tanke). Me detyrat që kryente në kuadër të mbrojtjes së përgjithshme të vendit, sipas Artit Ushtarak, Arma e Tankeve ishte forca kryesore goditëse e trupave tokësore. Më 1 shtator 1971, u hap kursi për tanke në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë. Hapja e kursit për tanke, programi që përvetësohej nga kuadrot tankistë, e rriti nivelin me atë të këmbësorëve, artiljerëve tokësorë e kundërajrorë, xhenierëve etj., që e kryenin kohë më parë kursin për armët e tyre. Kuadrot tankistë pas shkollimit i përcaktonin vetë detyrat për njësitë, repartet e nënrepartet e tyre. Me aftësitë e autoritetin e tij, Abaz Fejzo e çoi Armën e Tankeve nga suksesi në sukses.

Në mesin e vitit 1974, Komanda e Tankeve dhe Mjeteve të Blinduara u kthye në drejtori të tankeve. Në vijimësi si në të gjithë ushtrinë u bënë shumë ndryshime. Në vitin 1975 u mbyll kursi i tankeve në Akademi, nga propozimi i drejtuesit tankist. Vendimi i Këshillit të mbrojtjes përfshinte vazhdimin e kursit për tanke në Akademi. Në këtë kohë ishte i pranishëm mendimi i momentit se midis taktikës së tankeve e taktikës së këmbësorisë nuk ka dallime thelbësore, por disa veçori të parëndësishme që nuk pengojnë zhvillimin e përbashkët të kursit në Akademi. Numri i kursit për tankistë nuk ishte plotësuar në sasinë e nevojshme të grupit mësimor, për të evituar këtë, drejtuesit tankistë pranuan në heshtje që akademistët tankistë të shpërndaheshin në grupet e këmbësorisë e të përgatiteshin me atë program që mësonin këmbësorët. Për njohuritë për taktikën e tankeve edhe akademistët tankistë bënë atë sasi orësh që bënë dhe akademistët këmbësorë. Ky veprim bëri përfundimisht fakt të kryer heqjen e kursit për tanke në Akademi. Në vendimin e Këshillit të Mbrojtjes për armët e shërbimet e tjera, Ministria e Mbrojtjes lejohej t'i hapte vetë kurset për to kur e kishte të nevojshme. Ndërsa për kursin për tanke duhej të mblidhej Këshilli i Mbrojtjes e të vendoste hapjen e tij se tankistët e mbyllën vet atë. Ai kurs nuk u hap asnjëherë sa ekzistoi Arma e Tankeve.

Dega e Tankeve, e krijuar në vitin 1974, kishte drejtor Aleko Kokën. Më pas u emërua Lili Bullari. Në vijimësi drejtor i Tankeve u emërua Refat Gjyzeli e në fund të viteve 1990, Kujtim Nasupi. Pas vitit 1974 u vazhduan arritjet për përmirësimin cilësor të kushteve për jetesë e stërvitje. Zëvendësimi i shoferëve ushtarë me nënoficerë profesionistë me pagesë për guidimin e tankeve, transportuesve të blinduar ndikoi së tepërmi për zhvillimin më cilësor të stërvitjes. U ndërtuan ambiente e poligone më cilësore, ambiente të shumëllojshme për aktivitete sportive e argëtimi pas stërvitjes etj. Vendimtare për arritje ishte ndihma financiare e shtetit. Krahaz arritjeve u vërejtën dhe disa mangësi që ndikuan në zvogëlimin gradual të rolit të armës së tankeve si forca kryesore goditëse e forcave tokësore e përcaktuar në AUP. Meqë tanket vareshin nga drejtuesit këmbësorë, kjo nuk do të thoshte që ata të na diktonin në taktikën e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit, në probleme që ndikonin në uljen e gatishmërisë së Armës së Tankeve etj. Vetë ne u dhamë mundësinë për heqjen e kursit për tanke në Akademi.



**P**ortreti i malësore, pikturuar prej Simon Rrotës më 1923, i dha jetë vajzës që dilte prej maleve. Ajo shfaqet elegante, me duart e vendosura në brez dhe ca vathë që i varen poshtë shamisë. Një pikturë ku nuk mungojnë elementët jetësorë të sinjifikuar me gruan si uji apo dielli.

Pikturat e realizuara prej Kol Idromenos e Simon Rrotës janë dhe pikturat që shënojnë fillesat e artit të pikturës në Shqipëri, art i cili deri në ato kohë është realizuar në mënyrë sporadike nga anonime.

Në fondin e Galerisë së Arteve, veprat që ruhen datojnë nga fundi i shekullit XIX, periudhë që shënon fillesat e pikturës jofetare shqiptare. Autori i hershëm i pikturës është Kol Idromeno, vepra e të cilit “Motra Tonë” daton në vitin 1883.

Pikturat e para në Shqipëri manifestojnë një lloj amatorizmi. Kjo lloj fryme vazhdon deri në vitet 1930 kur fillon përpjekja për ngritjen e shkollës dhe institucioneve të artit në vend. Gjithsesi, këto piktura flasin qartë për atmosferën kulturore në Shqipërinë e viteve para të shekullit XX, si dhe përbëjnë dokumente të mirëfilltë etnografikë dhe historikë të periudhës. Këto vepra tregojnë dhe një lloj fryme romantike. Autorët e tjerë të epokës janë Pjetër Marubi, Simon Rrota, Zef Kolombi, Spiro Xega etj. Hapja e shkollës së vizatimit në Tiranë, në vitin 1931, do të sjellë dhe një ndryshim në konceptin e pikturës në vend, duke e kthyer atë në një pikturë realiste. Disa nga piktorët e parë që studiojnë aty janë Sadik Kaceli, Abdurrahim Buza, Gani Strazimiri etj., megjithatë pak vepra të tyre nga periudha e kësaj shkolle ruhen në fondin e Galerisë së Arteve.

Piktura realiste do të zhvillohet dhe nga piktorë që kthehen nga studimet në vendet fqinje, si: Odhise Paskali, Andrea Kushi,



Vangjush Moi, Janaq Paço, Foto Stamo, Motrat Zengo etj. Këta artistë përbëjnë brezin e artistëve të shkolluar të cilët përpiqen të zhvillojnë portretin, natyrën e qetë, peizazhin etj. Karakteristikë e veprave të kësaj periudhe që ruhen në GKA është përpjekja e artistëve për të përvetësuar teknikat artistike dhe një interes për pasqyrimin e realitetit me vërtetësi. Nëse shohim veprat e realizuara në këtë periudhë ato janë kryesisht portrete. Vangjush Moi, realizon me kujdes në vitin 1919 portretin e një vajze duke studiuar. I ardhur nga shkolla italiane e artit, Mio e bën fustanin e saj të hapur, duke i nxjerrë në pah supet. Andrea Kushi më 1939 vizaton me kujdes gërshetat e gjatë të një vajze e cila ka veshur një bluzë të bardhë.

Gratë e pikturuara nga Zef Kolombi janë të trishtuara në këtë periudhë. Po kështu dhe malësorja e Nexhmedin Zajmit (1947). Në këtë periudhë kemi dhe lëvrimin e artit të pikturës edhe nga artiste femra si Sofia Papadhimitri. Ndërsa endemi në koleksionin e veprave të ruajtura në Galerinë Kombëtare të Arteve kalojmë në një tjetër periudhë, e cila është ajo e pikturave akademike ku



# Jeta shqiptare mes penelit dhe telajos

dominon tabloja me temë historike (1950-1986).

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së regjimit komunist, në Shqipëri filloi të zhvillohej tabloja me temë historiko-politike. Kryesisht vendin më të madh në këto tablo e zë lufta antifashiste dhe ndryshimet historike në vend, por në të njëjtën kohë trajtohen dhe aspekte të ndryshme të historisë së Shqipërisë si ai i qëndresës së Skënderbeut etj. Por pavarësisht kësaj periudhe, Sali Shijaku më vitin 1961 pikturon një femër nudo të shtrirë në shtrat dhe trupin që i reflektohet në pasqyrë. Artistët kryesorë janë ata që kanë mbaruar akademitë perëndimore dhe reflektojnë një formim akademik në pikturën e tyre si: Nexhmedin Zajmi, Sadik Kaceli,



Abdullah Cangolli etj., ndërkohë që artistë të tjerë që formohen në Akademinë e Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të lindjes janë: Sali Shijaku, Fatmir Haxhiu, Vilson Kilica etj.

Ndërtimi i Modeleve të Njeriut të Ri (1960-1986) “Aksionistja” me autor Hasan Nallbanin, ku shfaqet portreti i një gruaje me flokët e prera shkurt, veshur me një bluzë të thjeshtë, pantallona dhe një shall të lidhur në qafë, teksa mban një sëpatë mbi supet, të tregon se tashmë ke mbërritur një moment nga më interesantët dhe më të diskutueshmit në historinë e artit pamor në Shqipëri, ai i artit të Realizmit Socialist. Pak më tej “Brigadierja” e Spiro Kristos (1976) ka ndaluar diku mes arës ku po punohet dhe mban një bllok shënimesh në dorë... “Montatori” i Petro Kokushtës, më 1979, valëvit flamurin në një moment pune...

Me kthimin e artistëve nga shkollat lindore të artit mund të thuhet se fillon epoka e Realizmit Socialist në artin shqiptar. Ky art është kryesisht në funksion të propagandës së regjimit politik në vend. Sipas klisheve të gatshme të importuara nga vendi i origjinës Bashkimi Sovjetik, arti fokusohet te punëtorët dhe veprimtaria e tyre, duke i kthyer këta në mite të kohës. Në fakt, Realizmi Socialist nuk përpigjet të tregojë me vërtetësi aspekte të realitetit të klasës punëtore, por të ngrejë një lloj kulti të punës socialiste si veprimtari dhe të punëtorit si personazh qendror të “një epoke të re” që ka filluar.

Artistët që kanë lënë vepra të spikatura në këtë drejtim janë Muntaz Dhrami, Zef Shoshi, Çlirim Peka etj. Një tjetër koleksion i rëndësishëm në Galerinë e Arteve është dhe ai i Pikturës Formaliste që gjen vend në historinë e pikturës shqiptare në fillim të viteve '70-të. Kjo pikturë krejtësisht nën ndikimin e pikturës moderniste perëndimore përpigjet të gjallojë, duke respektuar temat zyrtare të Realizmit Socialist, që janë më së shumti ato të punëtorit në frontin e punës, por që me mënyrën e të pikturuarit në fakt kërkon drejt një zhvillimi piktoresk dhe ka tendencën për t'iu përqasur rrymave të ekspresionizmit, fovizmit, kubizmit etj. Artistët kryesorë që kanë vepra të kësaj natyre në fondin e GKA-së janë: Edison Gjergjo, Alush Shima, Isuf Sulovari, Eduard Hila, Bajram Mata etj. Në një moment pune, në vitin 1970 Jorgji Gjokopulli sjell një grup të rinjsh të veshur plot ngjyra. “Mjelësja” e Isuf Sulovarit, duket e lumtur teksa pozon me kovën e qumështit në dorë. “Një emancipim” i gruas në pikturë duket dhe në një tablo të Llambi Blidos më 1971, me titull “Në pultin e komandimit”. Koleksioni i fundit që ruhet në Galeri, është ai i pikturave dhe skulpturave moderniste (1989-2001).

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Duke folur në një panel transatlantik të nivelit të lartë mbi klimën dhe sigurinë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg theksoi rëndësinë për sigurinë e trajtimit të ndryshimeve klimatike dhe sigurimit të një tranzicioni të energjisë së gjelbër. Sekretari i Përgjithshëm argumentoi se ne nuk mund të bëjmë kompromis për efektivitetin ushtarak dhe se forcat tona të armatosura duhet të jenë të gjelbra dhe të forta.

Stoltenberg tha se lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka treguar se siguria e energjisë është e lidhur ngushtë me luftën kundër ndryshimeve klimatike. Ai paralajmëroi se ndërsa vendet reduktojnë varësinë e tyre nga nafta dhe gazi rus dhe rrisin energjinë e rinovueshme, ato nuk duhet të krijojnë mbivarrësi të reja, për shembull nga burimet nga tokat e rralla kineze.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, mori pjesë në panel së bashku me Përfaqësuesin e Lartë të BE-së/Zëvendës Komisionit Evropian Josep Borrell, të dërguarin e posaçëm presidencial të SHBA-së për Klimën John Kerry dhe Zëvendës Presidentin Ekzekutiv të Komisionit Evropian Frans Timmermans. Veprimtaria u organizua nga Fondi Gjerman Marshall i Shteteve të Bashkuara, më 21 qershor 2023.

#### Forcat tona të armatosura duhet të jenë të gjelbra dhe të forta

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s ka qenë një zë i rëndësishëm për klimën dhe sigurinë edhe para se ai të ishte në postin e tij të lartë në NATO. Por me të ardhur në krye të Aleancës ai bëri të mundur vendosjen e klimës dhe sigurinë në qendër të agjendës së NATO-s. Por ndërsa lufta zhvillohet në kontinentin evropian, ai thekson se pse është e nevojshme që siguria ushtarake të ketë siguri klimatike. “Në Evropë po zhvillohet një luftë e nxehtë, por NATO duhet të trajtojë ndryshimet klimatike, sepse NATO nuk mund të mbetet një Aleancë e karburanteve fosile në epokën e burimeve të rinovueshme dhe lufta në Ukrainë ka treguar në fakt se si energjia dhe ndryshimet klimatike apo siguria janë të lidhura”, - thotë Jens Stoltenberg. Sepse presidenti Putin, thekson ai, përdori energjinë, gazin për t’i detyruar aleatët e NATO-s që të ofrojnë mbështetje për Ukrainën dhe kjo tregon lidhjen midis energjisë dhe ndryshimeve klimatike dhe sigurisë. “Ndryshimi i klimës ka rëndësi për sigurinë, kështu që ka rëndësi edhe për NATO-n, dhe për këtë arsye ne e kemi vendosur ndryshimin e klimës shumë më lart në axhendën e NATO-s gjatë dy viteve të fundit, prandaj nuk mjafton “jo vetëm të themi se ky është një problem, por ne përpiqemi të bëjmë diçka me të”, - tha Stoltenberg. Duke folur në panelin transatlantik të nivelit të lartë mbi klimën dhe sigurinë, Sekretari i Përgjithshëm përmendi tre fusha të rëndësishme ku Aleanca aktualisht po trajton ndryshimet klimatike. Së pari, ai përmendi fushën e emetimeve. “Ne duhet të zbusim dhe të reduktojmë emetimet, sepse nëse shikoni tanket e betejës, anijet luftarake, bombarduesit e mëdhenj, ka shumë gjëra, por ato nuk janë shumë miqësore me klimën, sepse ato konsumojnë shumë lëndë djegëse fosile dhe kanë nevojë për shumë. Pra, nëse do të arrijmë zero neto globale, duhet gjithashtu të reduktojmë emetimet mjaft të konsiderueshme nga aktivitetet ushtarake, të cilat zënë vend edhe në kohë paqeje”. Dhe për ta ilustruar këtë, Stoltenberg solli shembullin e stërvitjes të fundit ajrore në Gjermani. Ai ishte në bazën ajrore “Jagel” për të vizituar stërvitjen “Air Defender 2023”, stërvitja më e madhe e dislokimit ajror në historinë e NATO-s, me pjesëmarrjen e rreth 10 000 personel dhe 250 avionë nga 25 vende. “Unë u ktheva dje nga stërvitja më e madhe ajrore e zhvilluar ndonjëherë në NATO, në Gjermani, dhe natyrisht, ne lëshuam shumë CO2 me gjithë ata avionë që fluturonin në ajër. Prandaj, ne duhet të zhvillojmë teknologjinë, kemi një fond inovacioni dhe kemi një qendër përsosmërie në Kanada për ndryshimet klimatike”, - theksoi shefi i NATO-s. “Tani aleatët filluan të hedhin hapat për të gjetur mënyra për të reduktuar emetimet pa ulur efektivitetin e aftësive tona ushtarake. Sepse nëse aleatët detyrohen të zgjedhin midis një tanku të gjelbër miqësor ndaj klimës ose një tanku të fortë betejë, ata do të zgjedhin tankun e fortë të betejës, pra, mënyra e vetme për ta bërë këtë është të bihet dakord për nevojën miqësore me klimën, por edhe me efektivitetin ushtarak në kapacitete të ndryshme. Gjërat po ecin në drejtimin e duhur tha ai dhe informoi se NATO ka mjete për të investuar më shumë në teknologji”.

Si moment të dytë, Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi përshtatshmërinë, sepse ngrohja globale ndryshoi mjedisin tonë të sigurisë. “Më shumë konkurrencë mbi burimet e pakta, toka, uji, miliona njerëz të detyruar të ikin, por edhe ushtria, ata veprojnë jashtë. Sa më shumë përmbajtje që ka mot më ekstrem, më shumë valë e të nxehtit do të ndikojnë në gjithçka, nga uniformat tek doktrinat e deri te pajisjet, kështu që ne duhet të përshtatemi. Rritja e nivelit të detit prek një pjesë të madhe të bazave detare të NATO-s, pra Aleanca duhet të përshtatet, duhet të ndryshojmë mënyrën se si ne në fakt kryejmë operacione ushtarake”.

Si moment të tretë por po aq të rëndësishëm Stoltenberg theksoi se NATO duhet t’i paraprijë situatave që mund të vijnë. “Të sigurohemi që të mos krijojmë dobësi të reja, sepse pamë se sa të pambrojtur ishim kur do të vareshim nga gazi rus. Tani ne mirëpresim tranzicionin që po udhëheq BE-ja në kalimin nga gazi rus në energji dhe burime të tjera dhe më të qëndrueshme, nga energjia diellore në erë, tek energjia

# NATO dhe BE bashkëpunojnë për të adresuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në paqe dhe siguri



elektrike, tek bateritë, - tha ai. - Por problemi i vetëm është se duke bërë tranzicionin që mbështetet nga të gjithë ekziston rreziku i krijimit të dobësive të reja në mineralet e rralla të tokës nga Kina, për lëndët e para dhe produktet kritike. Pra, ne nuk duhet të bëjmë të njëjtin gabim edhe një herë, dhe për këtë arsye ne kemi nevojë si aleatë, si BE, si NATO të punojmë se si të rrisim prodhimin tonë të mineraleve të rralla të tokës dhe si të gjejmë teknologji të tjera që nuk na bëjnë të varur nga mineralet e rralla kineze të tokës”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

“Gjëja e fundit është thjesht të themi se kur e bëjmë këtë, kur zbatojmë tranzicionin, duhet të jemi të gjelbër dhe duhet të jemi bashkë, sepse nëse përfundojmë se disa aleatë kanë tanke betejë elektrike dhe të tjerët kanë lëndë djegëse fosile, ne do të mos jemi në gjendje të bëjmë atë që është një nga detyrat kryesore të NATO-s: ndërveprueshmërinë, që ne mund të ngarkojmë dhe të ushqejmë në të gjithë kombet dhe aleatët. Ky është nënvizimi i rëndësisë së NATO-s si një platformë ku aleatët vendosin standardet, siç kemi bërë gjithmonë, për të siguruar këmbësorshmërinë dhe ndërveprueshmërinë për të pajtuar më pas nevojën për një Aleancë të fortë me një Aleancë të gjelbër dhe miqësore me klimën dhe për këtë arsye, është një gjë e shkëlqyer, kënaqësi për të punuar me Shtetet e Bashkuara, BE dhe të gjithë të tjerët që po mbështesin këto përpjekje”, - përfundoi shefi i NATO-s.

#### Ndryshimet klimatike kërcënim ekzistencial për planetin

Paneli i përbërë nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë/Zëvendës Presidenti i Komisionit Evropian Josep Borrell, i dërguari special presidencial i SHBA-së për klimën John Kerry, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dhe Zëvendës Presidenti Ekzekutiv i Komisionit

Evropian Frans Timmermans, që u takua në Bruksel për të diskutuar ndikimet e ndryshimeve klimatike në paqe dhe siguri, në fund të diskutimeve doli me një deklaratë për shtyp të nënshkruar mbi Klimën dhe Sigurinë.

Deklarata specifikon se paneli përsëriti se ndryshimet klimatike dhe degradimi mjedisor janë një kërcënim ekzistencial për planetin dhe gjithashtu kanë implikime negative të menjëhershme, të drejtpërdrejta dhe në rritje për sigurinë dhe mbrojtjen”.

Për këtë qëllim, theksohet më tej në deklaratë, NATO dhe BE do të vazhdojnë të forcojnë bashkëpunimin e tyre për të adresuar pasojat e ndryshimeve klimatike në siguri. Duke u mbështetur në Planin e Veprimit të NATO-s për Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë, dhe Komunikimin e Përbashkët të ardhshëm të BE-së mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe degradimit të mjedisit në paqe, siguri dhe mbrojtje, BE dhe NATO do të eksplorojnë mundësitë për një dialog të intensifikuar mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe sigurinë”.

Në krye të Dialogut të dytë vjetor të nivelit të lartë të NATO-s mbi Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë në Samitin e Vilnius-it dhe Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike (COP28) 2023 në Dubai, ata do të kërkojnë të identifikojnë mundësitë për të bashkëpunuar për njohuri të reja dhe informacione operationale, në lidhje me aspektet e sigurisë të ndryshimeve klimatike dhe degradimit të mjedisit, standardeve të gjelbra dhe efikasitetit të energjisë, duke përfshirë matjen e emetimeve të gazeve serrë nga aktivitetet dhe instalimet ushtarake me qëllim të reduktimit të këtyre emetimeve. Në përfundim deklarata thekson se “Ata vendosën të vazhdojnë takimet e nivelit të lartë për këto çështje, me përfshirjen e gjerë të partnerëve, duke përfshirë COP28”.



## Sekretari i Përgjithshëm vlerëson kontributin e Malit të Zi në NATO, rol kyç në Ballkanin Perëndimor



Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg mirëpriti Presidentin Jakov Milatović në selinë e NATO-s, duke e falënderuar atë për kontributet e shumta të Malit të Zi në sigurinë tonë të përbashkët. Ai theksoi rolin kyç të Malit të Zi në promovimin e stabilitetit dhe paqes në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë kontributin e trupave në misionin paqeruajtës të KFOR-it në Kosovë.

“Angazhimi i NATO-s ndaj KFOR-it dhe mandatit tonë të Kombeve të Bashkuara është i palëkundur”, - tha z. Stoltenberg, duke vënë në dukje se KFOR-i ka rritur praninë e tij në përgjigje të tensioneve të vazhdueshme. Më tej, ai u bëri thirrje të gjitha palëve që të de-përshkallëzojnë dhe të kthehen menjëherë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, duke e quajtur këtë “çelës për sigurinë e qëndrueshme në Kosovë dhe stabilitetin në rajon”.

# Ndikimi i teknologjisë në procesin e të mësuarit

Teknologjia ka luajtur gjithmonë një rol kyç në jetën tonë, por falë aksesueshmërisë në rritje të pajisjeve inteligjente dhe kurrikulave të bazuara në ueb, përdorimi i saj tani është më i zakonshëm se kurrë. Përparimi i teknologjive aktuale dhe fuqia llogaritëse e pajisjeve fantastike të avancuara luajnë një ndikim të rëndësishëm në arsimin në ditët e sotme.

Inteligjenca Artificiale është një nga këto teknologji të lulëzuara që po përdoret në arsim për të bërë një ndryshim të madh. Falë inteligjencës artificiale në arsim, mësuesit, studentët, prindërit dhe sigurisht vetë institucionet arsimore e konceptojnë arsimin nga një këndvështrim krejtësisht i ri. Megjithatë, pavarësisht nga popullariteti i saj, AI-ja, për më tepër, ka të metat e veta.

Shumë shkolla në mbarë globin e kanë adoptuar tashmë atë. Por çfarë është saktësisht Inteligenca Artificiale në Arsim (AIED)? A do t'i tejkalojnë vërtet përshtypjet pozitive të inteligjencës artificiale disavantazhet e saj në fushën e arsimit? Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, duhet të merremi me avantazhet dhe disavantazhet e inteligjencës artificiale në arsim.

## Përkufizimi dhe avantazhet e inteligjencës artificiale në arsim (AIED)

Simulimi i vizionit njerëzor, vendimmarrjes dhe proceseve të tjera, AI, është një strategji për përdorimin e kompjuterëve dhe teknologjive të tjera për të përfunduar detyrat dhe për të vepruar si një njeri. Për ta thënë me fjalë të tjera, AI-ja i referohet njohjes së modeleve të nivelit të lartë dhe imitimit të sjelljes njerëzore në të cilën përfshihen robotët. Meqenëse kompjuterët mund të mësojnë dhe të përparojnë me kalimin e kohës, veçanërisht kur trajtojnë grupe të dhënash të mëdha dhe të komplikuar, AI-ja e bazuar në mësimin e makinerive për arsimim është më e suksesshme.

Në radhë të parë, AI-ja i vlerëson shkrimet dhe esetë shumë më shpejt se sa njerëzit. Të lirë nga detyrimet e lidhura me orarin, që kërkon kohë, mësuesit janë në gjendje të shpenzojnë më shumë kohë për të bashkëvepruar ngushtë me studentët për të zhvilluar aftësitë e tyre analitike dhe të menduarit kritik. Kjo lejon kreativitetin dhe ndjeshmërinë e nevojshme për të çuar mësimin në nivelin tjetër. Me këtë modifikim, instruktorët do të duhet të gjenerojnë aftësi të avancuara.

AI-ja e bazuar në mësimin e makinerive, për më tepër, mund të monitorojë sjelljen e studentëve dhe të zhvillojë modele që parashikojnë me saktësi performancën e studentëve. Teknika është dëshmuar më parë se tregon rezultate të shkëlqyera, kur zbatohet në situata të vështira që nuk kufizohen nga rregulla, duke përfshirë vlerësimin e përgjigjeve me shkrim të studentëve ose analizimin e grupeve të të dhënave të mëdha dhe të komplikuar. Nxënësit që marrin reagime të menjëhershme janë më të aftë të identifikojnë gabimet e tyre dhe të përmirësojnë veten.

Në ditët e sotme, inteligenca artificiale e bazuar në makineri përdoret gjerësisht në arsim dhe kompanitë që ofrojnë shërbime testimi si “Pearson” dhe Shërbimi i Testimit të Arsimit, vlerësojnë esetë duke përdorur përpunimin e gjuhës natyrore. Kurse masive të hapura në internet (MOOCs) si “Coursera” dhe “Udacity”, të cilat lejojnë pjesëmarrjen në internet nga kushdo, kanë përfshirë gjithashtu aplikacione të AI-së në arsim për vlerësimin dhe analizën e eseve.

## Shqetësimet në lidhje me zbatimin e AI-së në shkolla

Është e rëndësishme të merret parasysh vlera e marrëdhënieve ndërpersonale dhe natyra thelbësisht njerëzore e edukimit. E thënë thjesht, AI-ja në arsim nuk do të jetë në gjendje të zëvendësojë mësuesit.

Ekspertët gjithashtu theksojnë anshmërinë e AI-së si një disavantazh. Rezultatet e një numri masiv testesh do të përdoren për të gjeneruar rezultate të krijuara nga makina. Kjo çështje shkurtimisht thekson faktin se rezultatet e testit



Një makinë inteligjente artificiale që mëson një klasë nga një podium

mund të pasqyrojnë në të vërtetë mungesën e mundësive dhe jo mungesën e aftësisë. Dhe pikëzimi i makinës nuk do të jetë në gjendje të bëjë dallimin midis këtyre dallimeve.

Si pasojë e përfitimeve dhe disavantazheve të saj, inteligenca artificiale (AI) pritet të ketë një ndikim të jashtëzakonshëm në arsim dhe ka fuqinë për ta revolucionarizuar atë. Për të garantuar që inteligenca artificiale në arsim plotëson kërkesat aktuale, është thelbësore që arsimtarët, studiuesit e të mësuarit dhe politikëbërësit të bashkëpunojnë me shkencëtarët e kompjuterëve dhe zhvilluesit e AI-së.

Ne duhet të jemi të spikatur dhe të mos e kufizojmë vizionin tonë në përdorimin e teknologjive aktuale. Megjithatë, joshja e teknologjive inovative nuk duhet të na tundojë. Përkundër faktit se mund ta thjeshtojë shumë botën, AI-ja, duhet të konsiderohet me kujdes përpara se të përdoret për lehtësinë e njeriut ose në urinë për të luajtur me Zotin, pasi kjo mund të çojë në vetë-shkatërrimin e njeriut.

# Makina e leximit të ëndrrave

A keni menduar ndonjëherë të regjistroni dhe riprodhoni ëndrrat tuaja si një film? Sigurisht që përgjigja juaj do të jetë “Jo”. Por tani regjistrimi i ëndrrave tuaja nuk është më një ëndërr.

Një ëndërr është një seri mendimesh ose imazhesh që ndodhin në mendjen tuaj gjatë gjumit. Si me anë të një mrekullie, shkencëtarët japonezë kanë zbuluar një metodë për të regjistruar ëndrrat tuaja me anë të skanerit të imazherisë të rezonancës magnetike (Skaneri MRI).

Në këtë epokë të dixhitalizuar, zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë ka tejkaluar të gjithë kufijtë, duke bërë të arritshme gjithçka të mundshme. Në të vërtetë, njerëzit duket se po përjetojnë një transformim magjik.

Për të deshifruar imazhet në mendje gjatë gjumit me makinën e leximit të ëndrrave, ata i kanë integruar të dhënat në algoritmin që rindërton ëndrrat. Duke folur për algoritmin, ai mund të përdoret për të integruar të dhënat nga një tru në imazhet përkatëse të ndërlidhura. Fenomeni që ata kanë përdorur është fakti se truri i njeriut prodhon hormone kur ne ëndërrojmë gjatë gjumit.

Nga ana tjetër, hormonet e prodhuara nga truri lidhen me atë që kemi ëndërruar në gjumë. Për shembull, kur shohim një mi në ëndrrat tona, truri ynë do të prodhojë hormone për ta dalluar atë.

Studiuesit në Japoni përdorën skanime MRI për të zbuluar imazhet që njerëzit po shihnin ndërsa hynin në një fazë të hershme të gjumit.

Në revistën “Science”, ata raportuan se mund ta bënin këtë me 60% saktësi.

Ekipi tani dëshiron të shohë nëse aktiviteti i trurit mund të përdoret për të deshifruar aspekte të tjera të ëndërrimit, siç janë emocionet e përjetuara gjatë gjumit.

Profesor Yukiyasu Kamitani, nga Laboratorët e Neuroshkencës Kompjuterike ATR, në Kioto, tha: “Unë kisha një besim të fortë se deshifrimi i ëndrrave duhet të jetë i mundur të paktën për aspekte të veçanta të ëndërrimit... Nuk isha shumë i befusuar nga rezultatet, por i emocionuar.”

## Vala e trurit


Njerëzit janë përpjekur të kuptojnë ëndrrat që nga kohët e lashta egjiptiane, por studiuesit që kanë kryer këtë studim kanë gjetur një mënyrë më të drejtpërdrejtë për të shfrytëzuar vizionet tona gjatë natës.

Ekipi përdori skanime MRI për të monitoruar tre persona teksa flinin.

Pikërisht kur vullnetarët filluan të bien në gjumë brenda skanerëve, ata u zgjuan dhe u kërkuan të tregonin atë që kishin parë.

Çdo imazh i përmendur, nga statujat prej bronzit te çelësat dhe kazmat e akullit, u vu në dukje, sado surrealistike të kishte qenë. Kjo u përsërit më shumë se 200 herë për secilin pjesëmarrës.

Studiuesit përdorën rezultatet për të ndërtuar një bazë të dhënash, ku grupuan së bashku objektet në kategori të ngjashme



vizuale. Për shembull, hoteli, shtëpia dhe ndërtesa u grupuan së bashku si “struktura”.

Shkencëtarët më pas skanuan përsëri vullnetarët, por këtë herë, ndërsa ata ishin zgjuar dhe shikonin imazhet në një ekran kompjuteri.

Me këtë, ata ishin në gjendje të shihnin modelet specifike të aktivitetit të trurit që lidheshin me imazhet vizuale.

## Makinat e ëndrrave?

Gjatë raundit tjetër të testeve të gjumit, duke monitoruar skanimet e trurit, studiuesit mund të tregonin se çfarë po shihnin vullnetarët në ëndrrat e tyre. Ata ishin në gjendje të vlerësonin se në cilën kategori të gjerë ishin imazhet me saktësi 60%.

“Ne ishim në gjendje të zbulonim përmbajtjen e ëndrrave nga aktiviteti i trurit gjatë gjumit, i cili ishte në përputhje me raportet verbale të subjekteve”, - shpjegoi profesor Kamitani.

Studiuesit tani duan të shikojnë gjumin më të thellë, ku mendohet se ndodhin ëndrrat më të gjalla, si dhe të shohin nëse skanimet e trurit mund t'i ndihmojnë ata të zbulojnë emocionet, erërat, ngjyrat dhe veprimet që njerëzit përjetojnë ndërsa flenë.

Dr. Mark Stokes, një neuroshkencëtar nga Universiteti i Oksfordit, tha se ishte një pjesë “emocionuese” e kërkimit që na afroi më shumë me konceptin e makinave të leximit të ëndrrave.

“Është e qartë se është shumë larg, por nuk ka asnjë arsye pse jo në parim. Gjëja e vështirë është të përpunosh hartën sistematike midis aktivitetit të trurit dhe fenomeneve”, - shpjegoi ai.

Megjithatë, ai shtoi se një sistem i vetëm i leximit të ëndrrave nuk do të funksiononte për të gjithë.

“E gjithë kjo do të duhej të bëhej brenda lëndëve individuale. Kështu që ju nuk do të mund të ndërtoni kurrë një klasifikues të përgjithshëm që mund të lexojë ëndrrat e kujtdo. Ato do të jenë të gjitha idiosinkratike për individin, kështu që aktiviteti i trurit nuk do të jetë kurrë i përgjithshëm në të gjitha lëndët”, - tha ai.

“Ju kurrë nuk do të mund të ndërtoni diçka që mund të lexojë mendimet e njerëzve të tjerë, pa e ditur ata për këtë”.

# Dëshmorët e fshatit Vajzë – nder dhe krenari e kombit shqiptar



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

**L**ufta e Dytë Botërore është lufta më e shquar, më e organizuar dhe më e njohur e shqiptarëve, luftë që me zgjedhjen e aleatëve i renditi shqiptarët në krahun e fitimtarëve. Shqiptarët përzgjedhën për aleatë Ruso-Anglo-Amerikanët, boshtin fitimtar antifashist një histori suksesi dhe që i bëri shqiptarët ballëlartë në historinë e tyre, duke u renditur me fitimtarët dhe në anën e duhur të historisë. Pushtuesit nazifashistë në bashkëpunim me tradhtarët brenda vendit vepruan dhunshëm ndaj popullatës që mbështeti formacionet partizane dhe ca më keq ndaj atyre që bijtë e tyre i kishin dërguar si pjesëtarë të DPD-së të formacioneve partizane në çeta, batalione dhe brigadat partizane. Fashistët vetëm në fshatin Vajzë kanë kapur e pushkatuar dhjetë veta djem dhe burra të fshatit: Ferik Zagoll Bilbilaj, Dalan Mehmet Kamberaj, Beqir Osmani, Abdyl Osmani, Shaho Barjam Selimaj, Delo Mystehak Sulçaj, Sadedin Sherif Hazizi, Azbi Nurçe Hitaj, ndërsa dy kanë qenë gra: Këze Sulçaj, Pesare Kërroçaj. Nëse marrim në konsideratë gjithë aktivitetin e burrave dhe grave të pushkatuar, të torturuar e vdekur nga torturat, veprimtarinë në dobi të luftës dhe mënyra se si janë kapur nga armiku, qëndresa e tyre etj., me të drejtë u duhet akorduar titulli i lartë i Dëshmorit, sipas gjithë procedurave ligjore të ligjit nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, në nenin 5, “Kriteret për shpalljen e statusit “Dëshmor i atdheut”. Mënyra e rënies së tyre gjatë LANÇ-it klasifikohet në dëshmorë dhe jo viktimë. Ky problem është i hapur për organet kompetente që kërkon rishikim të themeltë sepse kanë ngelur në histori, në kujtesën familjare dhe të mbarë fshatit, në libra por edhe në këngë, meqenëse gjykojmë se ligjërisht ky problem nuk është zgjidhur, pasi opsionet e ligjit aktualisht janë të mundësishë së marrjes në konsideratë dhe rishikimit të mënyrës së rënies në luftë, sepse tashmë ligji është plotësuar dhe ka eliminuar paqartësitë dhe pasaktësitë e trajtimit real të të rënëve në fushën e nderit. Po i përmbledhim biografitë e të rënëve ende të pashpallur me titullin “Dëshmor”:

**Ferik Zagoll Bilbilaj**, lindur në Vajzë në vitin 1930, në një familje me tradita patriotike dhe luftarake. Fillimi i Luftës Nacionalçlirimtare, e gjeti Ferik Bilbilaj në moshë fare të re e të paformuar. Por ai u bë fillimisht një pionier i Rinisë Antifashiste, që erdhi gjithmonë duke u rritur, forcuar e burrëruar. Ai i shikonte me simpati të madhe burrat e rritur të fshatit që u rreshtuan me bindje të plotë në strukturat antifashiste. Nga ana tjetër ai i vërente me vëmendje dhe dëgjonte me kureshtje të madhe ata që vinin shpesh në kasollen e tij e ëndërronte të bëhej partizan, duke mallkuar veten që ishte ende i vogël. Por kjo nuk e pengoi për të qenë në shërbim të çetës së fshatit



si korrier, si mbledhës i ndihmave në veshmbathje e ushqime për partizanët dhe për transportimin e municioneve. Familja e tij, babai, Zagolli dhe të dy vëllezërit, u lidhën që në fillim me partinë dhe u bënë një ndër bazat kryesore në Vajzë. Feriku si i vogël që ishte nuk binte në sy, ndaj kryente në shumë raste detyrën e korrierit partizan. Ishte një djalë i shkathët dhe i zgjuar. Më 30 nëntor të vitit 1943, kur zhvilloheshin luftime të ashpra në Vajzë, Pllaçë e gjetkë, tërë familjet e fshatit dhe të fushës u larguan dhe u fshehën në pyje. Një ditë Feriku po shkonte nga përroi i Amonicës drejt pyllit të Kuliut që ndodhej afër kasolleve të familjes së tij. U diktua nga forcat gjermane, të cilat hapen zjarr kundër tij si njeri i dyshimtë. Nga zjarri i mitralozit fashist mbeti i vrarë pionieri trim Ferik Bilbilaj. Megjithëse njëherazi armiku e goditi edhe me mortajë, duke ja ndarë pothuaj trupin dhe kur ishte duke dhënë shpirt i thotë kunatës së tij Peshqeshes: “Mos u vrave gjë?”. Dhe në fakt pa prituri përgjigjen që i vinte “jo”, ndërroi jetë nga plagët e shumta që kishte marrë nga mortaja dhe mitralozi armik. Ferik Bilbilaj ra për të mos vdekur kurrë, sepse ngeli në memorien e të gjithë brezave të fshatit Vajzë, të mbarë krahinës dhe të gjithë Shqipërisë. Fakt është se pleqësia e fshatit e ka evidentuar si një ndër të rënë për Atdhe, që plotëson gjithë kriteret ligjore për t’u shpallur me titullin e lartë dhe të nderuar “Dëshmor i Atdheut”.

**Dalan Mehmet Kamberaj**, lindur në fshatin Vajzë më 1893. Ambienti dhe oxhaku patriotik ku erdhi në jetë e edukoi me frymë atdhedashurie dhe që më vonë do të bëhej një patriot i shquar e burrë i mençur i fshatit Vajzë në vitin 1893, me profesionin bari. E urrente fashizmin dhe shpejt edhe ai si gjithë bashkëfshatarët e tij e simpatizoi lëvizjen nacionalçlirimtare dhe jepte ndihma për luftën. Vetë nuk mori pjesë në luftë, por ishte më shumë se një luftëtar, në mbështetje të partizanëve

dhe të këshillit Nacionalçlirimtar të fshatit Vajzë. Dalani u morr me ekonominë e tij, por në shtëpinë e tij priste vazhdimisht partizanë, pasi që edhe në gjendje disi të mesme ekonomike, edhe pse nuk e duronte dot pushtimin e vatrave tona. Më 16 prill të vitit 1943, në operacionin fashist që u krye për djegien e fshatit dhe arrestimin e mbi 60 burrave vajzotë aktivistë të luftës, Dalani u arrestua nga forcat italiane në kodrat e Ashamirit, në përfundim të fshatit dhe u shoqërua për në komandën fashiste italiane, duke u mbajtur i lidhur këmbë e duar. Gjatë rrugës për në fshat, tentoi t’u ikte italianëve dhe të arratisë, por afër Tegesë, në një çast vendimtar që tentoi largimin drejt formacioneve partizane, fashistët hapën zjarr duke e lënë të vrarë në vend dhe duke ngelur në kujtesën e të gjithë brezave si një ndër të ekzekutuarit me breshëri automatiku, më 16 prill të vitit 1943, kur ishte në kulmin e energjive në moshën 50-vjeçare. Në gati gjysmëshekulli trajtohej si dëshmor edhe pse nuk i ishte akorduar titulli i dëshmorit, në fakt e kishte merituar prej kohësh.

**Këze Sulçaj**, lindur në pranverën e vitit 1898, kur në Shqipëri vijonte sundimi i gjatë pesë shekullor i sulltanatit osman. Ajo ishte një grua dhe një nënë me halle shumë në fshatin Vajzë. Ajo ishte nëna e dëshmorit Mete Mystehak Sulçaj dhe e viktimës Delo Mystehak Sulçaj, që meriton titullin “dëshmor”. Këzia ka qenë një ndër gratë e Vajzës, që megjithëse analfabete dhe e mbytur në fukarallëkun e saj, e simpatizonte Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe si nënë nuk i pengonte djemtë e saj, por krenohet që ata të punonin për luftën dhe çlirimin, për partizanët e çetës së fshatit dhe të krahinës që ishin ngritur me armë në dorë në luftë kundër pushtuesve. Sulçajt e kanë pasur traditë dyfekun, ndaj edhe djemtë e Këzes, duke pasur si drejtues të tyre djalë e gjetur të saj, Gani Sulçaj, shpejt e hodhën dyfekun në krah

dhe u bashkuan me djemtë e malit. Metja doli partizan në çetë, Delua aktivizohej me rininë antifashiste, kurse vetë Këzia priste e përcillte shokët e djemve të saj partizanë. Më 25 dhjetor 1943, kur forcat gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre ndodheshin nën goditjet e forcave partizane në Vajzë, Pllaçë, Velçë e deri në prapavijat e tyre, në kohën që po tërhiqeshin nga Vajza, ata kapën e pushkatuan disa fshatarë që njiheshin si strehues të partizanëve. Në këtë kohë vritet edhe Këze Sulçaj, në momentin që po tërhiqte një fshatar të ekzekutuar nga gjermanët në fund të fshatit Vajzë. Bashkëpunëtorët e fashizmit e njihnin Këzen si nënë të djemve partizanë dhe aktiviste të lëvizjes çlirimtare, dhanë urdhër që edhe ajo të pushkatohej dhe kështu u veprua. Ajo ishte e para grua nga Vajza që u ekzekutua nga nazistët gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tyre në atë operacion. Nazifashistët e dogjën fshatin Vajzë tre herë por nuk mundën që ta përkulnin. Këze Sulçaj ishte dhe mbeti një nënë heroinë jo vetëm për bijtë e saj që ia fali Atdheut, por edhe për sakrificimin e saj si dëshmore e pashpallur, por e nderuar dhe respektuar në tetë dekada. Ajo ra për lirinë e Atdheut në moshën 45-vjeçare për të mbetur përjetësisht e pavdekshme dhe që përkujtohet nga bashkëfshatarët e saj në ditët e dëshmorëve.

**Shaho Barjam Selimaj**, lindur në fshatin Vajzë në vitin 1890. Ai u rrit në një familje atdhetare e patriotike me tradita të shquara luftarake. Profesionin e tij kur u rrit ishte kovaç, por mbi të gjitha ka qenë një burrë i ndershëm e fukara, i përmendur në fshat e krahinë. Ai ka qenë një burrë 54-vjeçar, shumë i varfër nga ekonomia, i kërrusur nga hallet, por ishte një patriot i ndershëm që simpatizonte Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kishte besim tek djalëria që luftonte për lirinë e Atdheut. Edhe ai ishte larguar nga fshati për t’i shpëtuar terrorit nazifashist dhe



në kohën që forcat gjermane u tërhoqën drejt Vlorës, Shahua po kthehej në fshatin e tij të djegur e të plaçkitur nga fashistët. Duke kaluar rrugës nga Marovicat për në fshat diktohet nga patrulla gjermane më 28 janarin e vitit 1944. Patrulla gjermane po shkonte me motoçikleta gjatë rrugës automobilistike nga Plloça përgjatë fshatit Vajzë. Ata tentuan të kapnin viktimën, por ai u përpoq të largohej dhe për t’iu shmangur ndjekësve, sepse në fakt ishte një njeri i njohur si mbështetës i flaktë i idealeve të çlirimit dhe në mes të fukarallëkut të tij ndihmonte lëvizjen e forcave partizane me çfarë të kishte. Ndërkohë gjermanët hapën zjarr pa paralajmërim, duke e lënë të vrarë në rrugën automobilistike afër ullinjve të Vajzës, duke ngelur një memorial kujtese për papërkulshmërinë dhe që në zemër mbante idealet e çlirimit dhe të lirisë së vendit.

**Beqir Osmani**, Patriot i ndershëm që nuk u tremb nga vdekja. Lindi në Vajzë në vitin 1898, fshatar i varfër me profesionin bujk. U lidh që në fillim me lëvizjen nacionalçlirimtare, ishte në moshën 46-vjeçare, që ndonëse nuk ishte pjesë e formacioneve partizane me armë në dorë, ishte përgjatë gjithë kohës në mbështetje të lëvizjes antifashiste nacionalçlirimtare. Ndhimonte lëvizjen me gjithçka kishte mundësi. Kasollja e tij në fund të fshatit, ku ishte vendosur në Brahaj, ishte e hapur për partizanët që qarkullonin dendur në Vajzë në atë kohë. Beqir Osmani u kap nga bashkëpunëtorët e fashistëve në përroin e madh ku ishte fshehur në veri-perëndim të fshatit, iu dorëzua komandës gjermane, e cila pasi qe informuar se ky qe një strehues komunistësh, simpatizant e pjesëmarrës partizanë në formacionet e Luftës Nacionalçlirimtare, e torturoi për disa orë e pastaj e ekzekutoi përpara kasolles së tij, më 28 janar 1944, në afërsi të shtëpive të Sulçajve në Nastasaj. Beqir Osmani ishte i vëllai i Avdyl Osmanit dhe që të dy vëllezërit ngelën përjetësisht në memorie të kombit, por që në pritje të shpalljes me emrin e ndritur “Dëshmor”, titull që e kanë merituar prej kohësh.

**Avdyl Osmani**, lindur në fshatin Vajzë në vitin 1910 në një familje me tradita të shquara atdhetare e patriotike. Abdyli ndoqi shembullin e të vëllait, Beqir Osmani, duke u bërë bujk e blektor i mirë, por mbi të gjitha njeri me veti të spikatura njerëzore.

Ai sikurse vëllai i tij simpatizonte Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe shpresonte se edhe për të do të vinin ditë të bukura, ditë kur do të flakej tej fukarallëku i madh dhe shtypja e rëndë e të huajve.

Më 28 janar të vitit 1944, në Operacionin e Dimrit, ai ishte fshehur në një pyll të vogël në



SHQIPTARËT PËRZGJODHËN PËR ALEATË RUSO-ANGLO-AMERIKANËT, BOSHTIN FITIMTAR ANTIFASHIST NJË HISTORI SUKSESI DHE QË I BËRI SHQIPTARËT BALLËLARTË NË HISTORINË E TYRE, DUKE U RENDITUR ME FITIMTARËT DHE NË ANËN E DUHUR TË HISTORISË. PUSHTUESIT NAZIFASHISTË NË BASHKËPUNIM ME TRADHTARËT BRENDA VENDIT VEPRUAN DHUNSHËM NDAJ POPULLATËS QË MBËSHTETI FORMACIONET PARTIZANE DHE CA MË KEQ NDAJ ATYRE QË BIJTË E TYRE I KISHIN DËRGUAR SI PJESËTARË TË DPD-SË TË FORMACIONEVE PARTIZANE NË ÇETA, BATALIONE DHE BRIGADAT PARTIZANE.

Buduvenda të Vajzës për t’i shpëtuar ndjekjeve të gjermanëve. Avdylin e kapën forcat gjermane, të mbështetur edhe nga bashkëpunëtorët e tyre, e torturuan gati një ditë të tërë, duke i kërkuar të tregonte se ku ishin fshehur strehuesit e komunistëve, partizanët dhe aktivistët e lëvizjes në fshat. Ai nuk u tregoi asgjë gjermanëve dhe bashkëpunëtorëve edhe kur i thanë se do të pushkatohej. Pas shumë përpjekjesh me viktimën e tyre dhe duke parë se prej tij nuk mund të nxirrej asgjë, (edhe kur ndonjë bashkëpunëtor fashist kish thënë se ky ishte “deli”, edhe pse ai nuk ishte aspak i tillë). Prandaj gjermanët e pushkatuan në vend Avdylin dhe u larguan në kërkim të fshatarëve të tjerë të fshehur në zonën e fshatit Vajzë. Nga oxhaku “Osmani” janë dy të rënë që meritojnë titullin e lartë “Dëshmor”, Avdyl Osmani dhe vëllai i tij i madh Beqir Osmani.

**Delo Mystehak Sulçaj**, ka lindur në fshatin Vajzë në vitin 1929 dhe ishte burrëruar dhe bërë “djalë për pushkë”, siç quhej në Labëri për djemtë që u kishte “djersitur mustaqja”. Familja e tij ishte e varfër por e ndershme dhe gëzonte respekt në mbarë fshatin e krahinën. Njihet në breza që qëndrimi i tij përpara pushkatimit ishte qëndrim i një heroi lufte, që nuk iu drodh qerpiku. Delo Sulçaj u rrit në kushte të vështira ekonomike. Babai i vdiq shpejt, duke e lënë fare të vogël, në moshën 7-vjeçare. Delua me vëllezërit e tij u detyruan të punojnë hyzmeqar tek bejlerët e Vlorës për të siguruar bukën e gojës. Vëllai i tij më i madh Ganiu, herë i burgosur nga regjimi mbretëror e herë i arratisur, nuk mund të siguronte asgjë për familjen për të ardhura. Familja e Delos u lidh shpejt tërësisht me luftën, duke vënë në shërbim të saj gjithçka; shtëpinë, njerëzit dhe atë pak pasuri. Vëllezërit e tij Ganiu dhe Metja dolën partizanë,

nëna e tij me Delon e vogël bënin shërbime të tjera si bazë e luftës antifashiste. Ai si një i ri antifashist, u dallua për aktivitet në shërbim të luftës çlirimtare, kryente detyra korrieri, shoqërues i partizanëve nga njëra bazë në tjetrën etj. Gjatë operacionit të 30 nëntorit 1943 dhe pikërisht ditën teksa po zbriste nga Beuni, bashkëpunëtorët e fashistëve ishin fshehur dhe diktuan zbritjen nga mali të një personi të vetmuar. Kështu Delo Sulçaj si pjesë e familjes të lidhur fuqishëm me luftën partizane e kapin në befasi tek mullinjtë e Vajzës. Sapo zbriti në rrugë dhe kur po kalonte drejt përroit u kap dhe iu dorëzua gjermanëve menjëherë. Duke marrë informacion se kush ishte, gjermanët e pushkatuan po atë ditë afër vendit që quhet “Buza e Bletës” në Vajzë. I riu guximtar, 14-vjeçari Delo Sulçaj, nuk u përkul e as iu nënshtrua nazistëve gjermanë edhe para pushkatimit, duke e mbyllur jetën e tij fare të re me nder e dinjitet, si një i ri patriot antifashist i vendosur.

**Pesare Kërroçaj**, lindur në fshatin Vajzë të Vlorës në vitin 1906, që në fëmijëri u rrit si një vajzë trime që nuk i trembej syri para asnjë vështirësie. Oxhaku i saj familjar e kishte mëkuar me dashurinë për atdheun. Pesarja ishte një grua trimëreshë që nuk e trembën as kërcënimet e fashistëve dhe as vdekja. Jeto i në një familje shumë të varfër që e siguronte bukën e gojës me shumë vështirësi me hyzmeqarllëkun e djalit të saj Gjysh Kërroçaj. Edhe ajo u bashkua me gjithë gratë antifashiste të fshatit Vajzë dhe ndihmonte me ç’kish mundësi luftën Nacionalçlirimtare. Ishte një grua e zgjuar dhe e gojës, nga ato që në ato kohë e shikoje shpesh që të kuvendonte edhe me burrat e fshatit për problemet themelore dhe më të mprehta të fshatit. Në janar të vitit 1944 e kapën fashistët dhe bashkëpunëtorët e tyre në një kasolle

bagëtish ku qe fshehur për të mos rënë në dorë të tyre, men gjithë përpjekjet që bëri për t’u shpëtuar tradhtarëve, duke i sharë e mallkuar që merreshin me gra e fëmijë, nuk iu shpëtoi kriminelëve, të cilët e akuzuan si strehuese të partizanëve dhe aktiviste të lëvizjes Nacionalçlirimtare. Për qëndrimin e saj të vendosur pro LANÇ-it dhe duke mos mundur që ta detyronin të tregonte bazat partizanë dhe mbështetësit e luftës partizane e pushkatuan në oborrin e kasolles, në fshatin e saj Vajzë. Akti i saj trimëror edhe përpara pushkatimit ishte një burim frymëzimi për brezat, për atdhedashurinë dhe papërkulshmërinë edhe në situatat më kërcënuese për jetën edhe në momentet kur i morën jetën me vdekje me pushkatim. Breshëria e automatikut ia preu jetën në mes Pesare Kërroçajt, një nënë e fortë labe me virtyte të larta atdhetarie në mesditën e 30 janarit 1944.

**Sadedin Sherif Hazizi**, ka qenë një njeri fjalëpak, por punë dhe aktivitet të gjerë antifashist. Lindi në Vajzë në vitin 1898 në një familje me tradita patriotike. Vëllai i Sadedinit, Shefit Hazizi, mori pjesë në Luftën e Vlorës më 1920, ku edhe mori plagë të rënda, duke mbetur invalid tërë jetën. Në fillimin e Luftës Nacionalçlirimtare familja e Hazizajve u lidh me të që në vitin 1942. Kasollet e tyre në Belik, u bënë strehë e sigurt e njerëzve dhe formacioneve të para partizane të fshatit dhe të krahinës. Ata e ndihmuan luftën deri në fund me gjithçka kishin. Sadedini ishte dhe anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të fshatit që nga mesi i vitit 1943 dhe punonte me fshatarët e zonës së fushës deri sa u vra. Më 18 shkurt të vitit 1944 Sadedinin në mënyrë tinëzare e kapën bashkëpunëtorët e fashistëve gjermanë në afërsi të fshatit dhe e torturuan në mënyrë çnjerëzore, ndërsa Sadedini ishte i paarmatosur dhe në pamundësi për të bërë rezistencë. Bashkëpunëtorët e fashistëve kërkonin të dhëna për bazat partizane, bazat, aktivistët e luftës, mbështetësit e saj etj. E torturojnë dhe e akuzojnë si pjesëtar të LANÇ-it dhe si anëtar të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të fshatit dhe më në fund e pushkatojnë duke i marrë jetën vetëm se kishte përqaftuar idealet e lirisë dhe të çlirimit të Atdheut.

**Azbi Nurçe Hitaj**, lindur në fshatin Vajzë të Vlorës në marsin e vitit 1900. E gjithë familja e tij nëpër breza ka qenë e nderuar e respektuar për ndershmërinë punën dhe miqësinë e gjerë, besnike ndaj idealeve të atdhedashurisë. Të parët e tij kanë qenë luftëtarë ndaj të gjithë pushtuesve. Që në fillim të pushtimit kundër okupatorëve Azbi Nurçja së bashku me patriotë të tjerë si Rexhep Sulejmani, Sadik Karafili, Hajro Manaj, Hamit Rrapo etj, ku dhanë besën për të dalë në krah të djalërisë shqiptare për çlirim. Azbiu ishte i ndikuar dhe i prirur nga idetë përparimtare, edhe si mik i shkrimtarit të njohur Shefqet Musaraj, duke u bërë bazë e ideve antifashiste e përparimtare. Azbiu u zgjodh në Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar që me krijimin e tij, detyrë që e ushtroi deri ditën e arrestimit dhe të burgosjes së tij më 16.04.1943. Nazistët gjermanë i dogjën shtëpinë, i shkatërruan atë pak ekonomi që kishte e torturojnë në qelitë e burgut të Porto Romanos, por ai nuk u thye dhe qëndroi trimërisht përpara torturave çnjerëzore të pushtuesve nazi-fashistë, duke qëndruar besnik ndaj popullit dhe Atdheut. Fashistët i shkaktuan plagë shumë të rënda në trup por dhe goditje të rënda psikike, të cilat e sakatuan tmerrësisht, për të mos u kthyer më në gjendjen e mëparshme. Ai ngeli i gjymtuar rëndë edhe pas kthimit nga kampi i përqendrimit pas kapitullimit të Italisë fashiste, në shtator të vitit 1943 e deri sa mbylli sytë në vitin 1945 menjëherë pas përfundimit të luftës. Vdekja e tij nuk erdhi nga mosha, por u shua nga torturat çnjerëzore, duke mbyllur sytë përgjithmonë më 10 shkurt 1945, në agun e lirisë në moshën 45-vjeçare.

## QPR

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë, 3 (tre) të drejta studimi.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit është deri, më 12 korrik 2023.

Për më shumë informacion klikoni më poshtë:



<https://www.mod.gov.al/images/njoftime2023/qpr/qershor/studime-greqi/NJOFTIM-per-Studime-ne-Greqi.pdf>

## QPR

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Shkollat e Larta Ushtarake të Turqisë, 8 (tetë) të drejta studimi. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri, më 6 Korrik 2023.

Për më shumë informacion klikoni më poshtë:

<https://www.mod.gov.al/images/njoftime2023/qpr/rekrutim-maj/NJOFTIM-per-Studime-Turqi.pdf>

